8	<i>Emri Ajdini</i>		<i>Profesor i matematikës</i>	<i>VII</i>	<i>Mësues i matemat.</i>	-
9	<i>Sait Misimi</i>		<i>Profesor i historisë</i>	<i>VII</i>	<i>Mësues i historisë</i>	-
10	<i>Zeqirja Jonuzi</i>		<i>Mës. i historisë e gjeogr.</i>	<i>VII</i>	<i>Mës. i histor. e gjeogr.</i>	-
11	<i>Irfan Abdullahu</i>		<i>Mës. i historisë e gjeogr.</i>	<i>VI</i>	<i>Mës. i histor. e gjeogr.</i>	-
12	<i>Rexhep Misimi</i>		<i>Profesor i kimisë</i>	<i>VII</i>	<i>Mësues i kimisë e f.</i>	-
13	<i>Imer Imeri</i>		<i>Profesor i biologjisë</i>	<i>VII</i>	<i>Mësues i biologjisë</i>	-
14	<i>Afrudita Hajradini</i>		<i>Profesoreshë e biologjisë</i>	<i>VII</i>	<i>Mësues i biologjisë</i>	<i>Kohë të caktuar</i>
15	<i>Fatime Idrizi</i>		<i>Mësuese e BTP</i>	<i>VI</i>	<i>Mësuese e BTP</i>	-
16	<i>Enver Husmani</i>		<i>Profesor i a.figurativ</i>	<i>VII</i>	<i>Mësues i artit fig.</i>	-
17	<i>Skender Memedi</i>		<i>Profesor i A.F.sh.</i>	<i>VII</i>	<i>Mësues i biologjisë</i>	-
18	<i>Zemri Idrizi</i>		<i>Profesor i A.F.Sh.</i>	<i>VII</i>	<i>Mësues i biologjisë</i>	-
19	<i>Gajur Alimi</i>		<i>Mësues: Mat. - fizikë</i>	<i>VI</i>	<i>Mësues i mat. e f.</i>	-
20	<i>Merita Alimi</i>		<i>Profesoreshë e gj.e l.sh</i>	<i>VII</i>	<i>Mësuese e gj. shq.</i>	<i>Kohë të caktuar</i>
21	<i>Arlinda Elezi</i>		<i>Profesoresh e A.muzikor</i>	<i>VII</i>	<i>Mësuese e muzikës</i>	<i>Kohë të pacaktua</i>

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

### Ndarja e orëve ANGAZHIMI I MËSIMDH. (C.LËNDOR) ME ORË MËSIMORE (v.shk.2021-22) (Do të precizohet kur do të bëhet sistematizimi)

Arsimtarët	Lëndët mësimore	Gjith.	Klasat	Nr.i orëve			
				Lëndë det.	Mës.zgj.	K. kl.	
1.Sihana J.	Gjuhë shqipe	21	7,9	20	-	1	IX-1
2.Danjela Spasova	Gjuhë maqedone	20	6,7,8,9	20	-	-	-
3.Lirim Salihi	Gjuhë shqipe	21	6,8	20	-	1	VI-1
4.Bekim Imeri	Gjuhë angleze	21	6,7,9	15	-		
			5	6 (kl.U.)			
5.Valbona Salihi	Gjuhë angleze	22	6,7,8,9	21	-	1	VI-3
6.Hirem Selimi	Gjuhë gjermane	24	6,7,8,9	24	-	-	-
7.Luan Abdullahu	Matematikë	21	6,,7,8	20	-	1	VIII-2
8.Emri Ajdini	Matematikë	22	7,9	21	-	1	VII-1
9.Sait Misimi	Histori	19	6,7,8,9	16	-	-	-
	Arsim qytetar		9	1			
	Etikë		7	2			
10.Zeqirja Jonuzi	Histori	20	6,7,8,9	8	-	1	IX-3
	Gjeografi		7,8,9	8			
	Arsim qytetar		6,7	2			
	Etikë			1			
11.Irfan Abdullahu	Gjeografi	20	6,7,8,9	16	-	1	VI-2
	Ars.qytetar		7	3			
12.Rexhep Misimi	Kimi	17	8,9	12	-	1	VII-2
	Inovacion		9	2			
	Shkenca nat.		Kl.ultra	2			
13.Imer Imeri	Biologji	21	7,8,9	6	-	1	VII-3
	Edukim mjedisi		7	6			
	Përparim shëndeti		7	2			
	Shkenca natyrore		5,6	6			
14.Afërdita Baftjari	Biologji	21	7,8,9	12	-	1	VIII-1
	Përparim shëndeti		7	4			

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

	Shkencat natyrore		6	4	-	-	-
<b>15 .Fatime Idrizi</b>	Arsim teknik+ p.k.(m)	17	5,6	9		-	-
	Arsimi tek. zgjedhor		8		6	-	-
<b>16.Enver Husmani</b>	Arsim figurativ	20	6,7,8,9	12	-	-	-
	Projekte nga artit fig.		6		6		
	Inovacion		9	1		-	-
<b>17.Skender Memedi</b>	Arsim fizik e shënd.	20	6,7,8,9	18	-	-	-
	Sport zgjedhor				2	-	-
<b>18.Zemri Idrizi</b>	Arsim fizik e sh.	21	6,7,8	18		1	IX-2
	Sport zgjedhor				4	-	-
<b>19.Gajur Alimi</b>	Matematikë	21	6,8	8	-	1	VIII-3
	Fizikë		8,9	12	-		
<b>20. Zarije Arifi</b>	Gjuhë maqedone	22	6-9	10	-	-	-
			4,5	12 (kl.u)			
<b>21. Merita Alimi</b>	Gjuhë shqipe	8	7,9	8	-	-	-
<b>22. Arlinda Elezi</b>	A.muzikor	12	6,7,8,9	12	-	-	-
<b>23. Abdilsamet I.</b>	Etika e rel.	6		6	-	-	-
<b>24. Lejla Huseini</b>	Informatikë	6	6,7	6	-	-	-
		<b>445</b>				<b>12</b>	

### 8.3. Puna sipas ndërrimeve

Shkolla fillorekomunale "Eqrem Çabej" Sllatinë realizon mësimin në dy ndërrime: ndërrimi i paraditës (cikli lëndor, nga kl. VI-IX– nga arsimtarë lëndor, nga ora 07-30 min) dhe ndërrimi i pasditës (cikli klasor, nga klasa e I – V-të me mësimdhënës të ciklit klasor, nga ora 13-10 – 18-00). Në shkollën periferike (paralelja e kombinuar), nxënësit nga kl. I-V dhe dy mësimdhënëset realizojnë mësimin nga ora 8.

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

<b>Shkolla qendrore</b>	
<b>NDËRRIMI I PARË</b>	<b>NDËRRIMI I DYTË</b>
FILLON ME PUNË 7 <sup>30</sup> Min.	FILLON ME PUNË 13 <sup>10</sup> Min.
Kl.VI - 1,2; VII - 1,2; VIII - 1,2; IX - 1,2	Kl. I-1,2; II -1,2; III -1,2; IV -1,2; V - 1,2
<b>Shkolla periferike</b>	
<b>NDËRRIMI I PARË</b>	<b>NDËRRIMI I DYTË</b>
FILLON ME PUNË 7 <sup>30</sup> Min.	FILLON ME PUNË 13 <sup>10</sup> Min.
kl:VI-3; VII-3; VIII -3; IX-3 Paralelet e kombinuara 8 – 30;	kl: I-3; II -3; III -3; IV -3; V - 3;

<b>Orari i ziles: TURNI I PARADITËS</b>			
<b>ORA</b>	<b>FILLIMI</b>	<b>MBARIMI</b>	<b>PUSHIMI</b>
1	7 <sup>30</sup>	8 <sup>10</sup>	5 min.
2	8 <sup>15</sup>	8 <sup>55</sup>	10 min.
3	9 <sup>15</sup>	9 <sup>45</sup>	15 min.
4	10 <sup>00</sup>	10 <sup>40</sup>	5 min.
5	10 <sup>45</sup>	11 <sup>25</sup>	5 min.
6	11 <sup>30</sup>	12 <sup>10</sup>	5 min.
7	12 <sup>15</sup>	12 <sup>50</sup>	5 min.

<b>Orari i ziles: TURNI I PASDITËS</b>			
<b>ORA</b>	<b>FILLIMI</b>	<b>MBARIMI</b>	<b>PUSHIMI</b>
1	13 <sup>00</sup>	13 <sup>40</sup>	5 min.
2	13 <sup>45</sup>	14 <sup>25</sup>	15 min.
3	14 <sup>40</sup>	15 <sup>20</sup>	5 min.
4	15 <sup>25</sup>	16 <sup>05</sup>	5 min.
5	16 <sup>10</sup>	16 <sup>50</sup>	5 min.
6	16 <sup>55</sup>	17 <sup>35</sup>	5 min.

I njeiti orar i ziles vlen për të dyja shkollat

Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

Shkolla periferike (paralelja e kombinuar)							
NDËRRIMI I PARË				NDËRRIMI I DYTË			
ora	fillimi i orës mës.	mbarimi i orës mësimore	pushimi	ora	fillimi i orës mës.	mbarimi i orës mësimore	Pushimi
1	8-00	8-40	5	1	-	-	-
2	8-45	8-25	15	2	-	-	-
3	8-40	9-20	10	3	-	-	-
4	9-30	10-10	10	4	-	-	-
5	10-20	11-00		5	-	-	-

-Kopje të orarit të orëve mësimore paraqitet në tabelën e shpalljeve të shkollës

**8.4. Gjuha / gjuhët në të cilat realizohet mësimi**

	<i>Gjuha mësimore - shqipe</i>	<i>Gjuha mësimore - maqedone</i>	<i>Tjetër</i>
<i>Numri i paraleleve</i>			
<i>Numri i nxënësve</i>			
<i>Numri i mësimdhënësve</i>			

## Programi vjetor Sh.F.K. “Eqrem Çabej” Sllatinë - Tearcë

### 8.5. Programi i zgjëruar

Gjatë vitit shkollor, konform mësimit të rregullt do të realizohet edhe program i zgjëruar për nxënësit, që do të përfshijmë aktivitetet vijuese:

(Aktivitetet për zgjërimit e programit realizohen me nxënës të cilët vijnë para mësimit dhe mbeten mbas mësimit. Nëse nuk ka nxënës të tillë të mësimeve të tillë, atëherë këto aktivitete nuk do të realizohen). Aktivitetet janë të përfaqësuara apo të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Muaj	Qëllimet	Mjetet	Koha për realizim	aktiviteti
Shtator-qershor	Zhvillimi i dashurisë, interesit dhe dëshirës për këndim; zhvillimi gatishmërisë për shfrytëzimin e mjeteve të artit figurativ; Zhvillimi i ndjenjës për shijen estetike; të nxitet të merr pjesë në lojë, të mësojë t'i respektojë rregullat e lojës; të zhvillojë aftësitë psiko-motorike: shpejtësinë, qëndrueshmërinë, reaktionin e drejtë dhe të matur; të zhvillojë aftësitë për sjellje të kontrolluar dhe të shprehurit e emocioneve në garë, kulturë në mbështetjen e tifozërisë; krijimi i veçorive pozitive të karakterit; të zhvillojë aftësi për aktrim, të zhvillojë sjellje shoqërore)	CD pleer, TV, materiale edukative	Nga 07:00 deri 08: 00 dhe Nga 12:00 deri 13:00	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shikimi i shfaqjes me rastin e pranimit të nxënësve në kl. I (parë);</li> <li>- Luajtje e lojrave edukative e shoqërore (nga shkronjë në shkronjë); Sendi i fshehur; pantomima; Asociacioni; Unë filloj-ti mbarojë; Godite fjalën; Gjeografi e shpejtë; Fjalëshpejta...)</li> <li>- Luajtja në oborr të shkollës (Topi popullor, Lejleku kërkon ngjyrë, Nata – dita, Loja me top, Patatja e nxehtë, Njeriu i ngrirë)</li> <li>- Lojëra në klasë (Nxehtë-ftohtë, Radhitja e katrorëve, Sendi i fshehur, Karrika muzikore, Domino, Mos u hidhëro, njeri, Lojë me letra etj.)</li> <li>- Shikimi TV (Filma vizatimor, Filma animues, Emisione edukative për fëmijë, Tregime popullore, Drama)</li> <li>- Dëgjim i audio-materialeve (Këngë, Radio-emisione për fëmijë).</li> <li>- Përgatitje të veprave të ndryshme artistike, Vizatime, Pano etj.</li> </ul>

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

### 8.6. Paralelja e kombinuar

Në shkollën tonë (periferike) funksion edhe paralelja e kombinuar me mësim në gjuhën maqedone

SHKOLLA PERIFERIKE – PARALELET E KOMBINUARA							
N. r.	Emri dhe mbiemri	Klasa	Nr. javor i orëve	Mësim shtesë	Mësim plotës.	Aktivitet e lira	Gjithsjet:
1.	Ivana Galovska	II, III, IV	22	1	1	1	25
2.	Tanja Trifunoska	I, V	22	1	1	1	25
GJITHSEJT ORË:			48	4	4	4	60
GJITHSEJT:							

### 8.7. Gjuhët e huaja që mësohen në shkollë

Si gjuhë të huaja mësohet gjuha angleze nga kl. I (parë) deri në kl. IX – si gjuhë e parë e huaj, ndërsa nga klasa VI deri IX mësohet gjuha gjermane si gjuhë e dytë e huaj.

Gjuha	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve
Gjuha angleze	29	490
Gjuha gjermane	9	191

### 8.8. Realizimi i arsimit fizik-shëndetësor me nxënësit nga kl. I-V

Mësimi në shkollën fillore ng kl.I deri IX përfshin të gjitha lëndët mësimore që janë të obligueshme sipas planeve dhe programeve mësimore që janë në kuadër të fondit të verifikuar të orëve.

Në bazë të ndryshimeve në Ligjin për arsim fillor e të mesëm, edhe këtë vit shkollor (2021/22) në kl. I-II dhe III në lëndën mësimore Arsimit fizik e shëndetësor mësimin do të realizojnë mësimdhënësit, Rihana Salih dhe Skender Memedi.

### 8.9. Mësimi zgjedhor

**(Do të harmonizohet me planin e ri mësimor-nga ana e MASH-it)**

Këtë vit mësimor në shkollën tonë do të realizohet lëndët e lira zgjedhore:

Krijimtari kl. IV- 1 orë në javë);

Krijimtari kl. V- 2 orë në javë);

Etikë e religjioneve në kl.e VI- 2 orë në javë);

Kultura klasike europiane në kl.VII, 2 orë në javë,

Projekt nga artit figurativ në kl.VIII – 2 orë në javë dhe

Përparimi i shëndetit në kl.IX-2 orë në javë.

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

N. r.	Lëndët zgjedhore	K L A S A T								
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
1	Krijimtari				1	2				
2	Etika në religjione						2			
3	Kultura klasike									2
4	Projekt nga arti figurativ								2	
5	Përparim shëndeti							2		
6	Shkathësi për jetë							2		
<b>G J I T H S E J T :</b>					1	2	2	4	2	2

### 8.10. Mësimi plotësues

Mësimi plotësues do të organizohet me nxënësit të cilët kanë vështirësi në të mësuar apo që ngadalë përparojnë ose që ngecin prapa në përvetësimin e përmbajtjeve të caktuara mësimore apo detyrave nga një apo disa lëndë mësimore. Në mësimin klasor mësimi plotësues do të realizohet me nga 1 orë në javë, ndërsa në atë lëndor do të realizohet me këtë renditje:

### Realizimi i mësimi plotësues

#### (Shkolla qendrore)

N. r.	Lëndët	Klasa	Orët			Realizuesi
			Javë	Muaj	Vit	
1	Gjuhë shqipe	VI	1	4	36	Lirim Salihi
2	Matematikë	VI	2	8	72	Emri Ajdini
3	Biologji	VI	1	4	36	Afërdita Baftjari
4	Gjeogr. - Histori	VI	1	4	36	Irfan Abdullahi*
5	Gjuhë gjermane	VI	1	4	36	Hireme Selimi
6	Gjuhë angleze	VI	1	4	36	Bekim Imeri
<b>G J I T H S E J T :</b>			7	28	252	

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

<b>(Shkolla periferike)</b>						
N. r.	Lëndët	Klasa	Orët			Realizuesi
			Javë	Muaj	Vit	
1	Gjuhë shqipe	VI	1	4	36	Merita Alimi
2	Matemat. - Fizikë	VI	1	4	36	Gajur Alimi*
3	Biologji - Kimi	VI	1	4	36	Imer Imeri*
4	Gjeografi.- Histori	VI	1	4	36	Zeqirja Jonuzi*
G J I T H S E J T :			4	16	144	
G J I T H S E J T I - II:			8	32	288	

### **8.11. Mësimi shtesë**

Mësimi shtesë dhe plotësues do të organizohet duke u bazuar në Ligjin për Arsim Fillor dhe Statutin e shkollës:

#### I

(1) Mësimi shtesë organizohet për nxënësit të cilët gjatë rrjedhës së punës mësimore tregojnë interes, prirje dhe talent të veçantë në lëndë të caktuar mësimore (nxënës të talentuar).

(2) Mësimin shtesë nga paragrafi (1) I këtij neni arsimtari është i obliguar t'ua ofrojë nxënësve, ndërsa nxënësit vendosin a do ta përcjellin mësimin shtesë.

#### II

(1) Mësimi plotësues organizohet me nxënësit të cilët kanë vështërsi në të mësuar apo që ngadalë përparojnë ose që ngecin prapa në përvetësimin e përmbajtjeve të caktuara mësimore apo detyrave nga një apo disa lëndë mësimore, përkatësisht nëse:

- kanë më së paku 2 nota të dobta,
- mungojnë nga mësimi në ndonjë lëndë të caktuar,
- me kërkesë të nxënësit apo prindit të tij, përkatësisht tutorit.

(2) Arsimtari i cili organizon mësimin sipas lëndës mësimore i obligon nxënësit nga paragrafi 1 neni 1 për ndjekjen e mësimin plotësues, ndërsa për nxënësit nga paragrafi (1) neni (2) dhe (3) mësim plotësues organizohet sipas vlerësimit të arsimtarit.

(3) Nxënësi i dërguar në mësim plotësues gjatë një muaji përcjell mësim plotësues më së tepërmi në dy lëndë mësimore me katër orë mësimore për një lëndë mësimore.

(4) Nëse nxënësi i caktuar në mësim plotësues, nuk e ndjek këtë, merr mungesë të paarsyeshme.

(5) Për dërgimin e nxënësit në mësim plotësues, arsimtari është i obligueshëm ta informojë prindin, përkatësisht tutorin.

\*Arsimtari i angazhuar me dy lëndë mësimore në javë, do të realizojë një lëndë në javën e parë (M.PI.) ndërsa javën e ardhshme do të realizojë lëndën tjetër.

## Programi vjetor Sh.F.K. “Eqrem Çabej” Sllatinë - Tearcë

\*Mësimi shtesë dhe plotësues realizohet përmes orëve mësimore të cilat janë të evidentuar në ORARIN SHKOLLOR TË ORËVE MËSIMORE, kopje të të cilit duhet të vendoset në tabelën e shpalljeve të shkollës dhe deponohet deri te Inspektorati shtetëror i arsimit.

### III

(1) Shkolla fillore më së voni deri 20 shtator gjatë vitit shkollor në vijim, harton një orar për mësim shtesë dhe plotësues për çdo lëndë mësimore, në vend transparent në shkollë dhe i njëjti deponohet deri te Inspektorati shtetëror i arsimit.

(2) Për arsimtarin i cili për shkaqe të panjohura nuk realizon mësimin shtesë dhe plotësues konform orarit nga paragrafi I, do të pasojë procedurë për masë disiplinore.

(3) Për masën disiplinore nga paragrafi (2) arsimtarit i parashtrohet masë disiplinore në para me gjobitje nga 10%-30% të rrogës mujore të nëpunësit publik në muajin para përbarimit të masës disiplinore, në kohëzgjatje der gjashtë muaj.

### 8.12. Puna me nxënës të zgjuar e të talentuar

Gjatë vitit shkollor, shërbimi profesional i shkollës, mësimdhënësit gjatë rrjedhës së punës mësimore në këtë vit, do t'i përcjellin nxënësit dhe me ndihmën e instrumenteve për identifikim të nxënësve të zgjuar, do t'i zbulojnë të njëjtët. Mandej mësimdhënësit do të punojnë me ata nxënës në orë të mësimin shtesë dhe aktivitetet jashtëmësimore, si dhe në përgatitjen e këtyre nxënësve për gara nga lënda konkrete mësimore, varësisht nga interesi i nxënësve. Gjatë rrjedhës së vitit shkollor, shkolla do të hartojë plan për punë me nxënësit e zgjuar dhe talentë, që do të përfshijë kohën e realizimit, mësimdhënësit, shërbimi profesional i shkollës dhe subjektë tjerë që do të jenë përgjegjës për realizimin e këtyre programeve.

Timi i shkollës fillore “Eqrem Çabej” në bashkëpunim me timet tjera të shkollës, pritet që në mënyrë të suksesshme të kryejë punën e saj. Nga ky vit shkollor shkolla jonë do të kërkojë të kyçet në ndonjë projekt që do të ketë për detyrë Mbështetjen e nxënësve të zgjuar dhe talentë, qoftë në nivel komunal, qoftë në nivel regjional apo kombëtar, i cili realizohet si Program i përbashkët i BE dhe K. të E. Me mbështetje të MASH-it.

<b>Anëtarët e timit</b>	
<b>Koordinator</b>	<b>Syrja Etemi</b>
<b>Zëvendëskoordinator</b>	<b>Valbona Salihi</b>
<b>Anëtarë</b>	<b>Zeqirja Jonuzi, Emri Ajdini, Ivana Gallovska</b>
<b>Bashkëpunëtor profesional</b>	<b>Albulena Idrizi</b>

\*Ky program do të realizohet sipas Programit (eventual) të ekipit komunal apo regjional

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

### Qëllimet:

- Përparimi i fëmijëve të zgjuar dhe talentë (NZT);
- Mbështetje individuale e NZT nga ana e nxënësve, arsimtarëve dhe shërbimit profesional;
- Rritja e bashkëpunimit dhe mbështetjes së prindërve të NZT me shkollën dhe institucionet e destinuara për këtë qëllim;
- Hartimi i planeve arsimore adekuate për identifikimin, punën dhe zhvillimin e aftësitë dhe nevojave të secilit nxënës.

<b>PROGRAMI PËR PUNËN E TIMIT ME NXËNËSIT E ZGJUAR DHE TALENTË</b> - Përgjegjës: Syrja Etemi						
<b>Aktiviteti programor i planifikuar</b>	<b>Koha e realizimit</b>	<b>Realizator</b>	<b>Burimet/ resurset</b>	<b>Metodat dhe ecuritë e realiz.</b>	<b>Efektet e pritura</b>	<b>Shënime</b>
Mbledhje e timit dhe përgatitja e programit për punë për vitin shk. 2021-22	Gusht 2021	Anëtarët e timit	Dokumente interne	Diskutim	Përmirësimi i punës së timit	-Në nivel të komunës, nuk ka iniciativë të këtillë
Identifikimi i nxënësve me nevoja të veçanta.	Shtator 2021	Timi; Mësimdhënës; Punëtorë profesionalë	Dokumente interne	Vëzhgim; Diskutim	Identifikimi i drejtë i nxënësve-për dhënien e ndihmës së mëtejme	
Vlerësimi i statusit zhvillimor të nxënësit	Shtator, Tetor 2021	Timi; Mësimdhënës; Punëtorë profesionalë	Dokumente interne	Vëzhgim; Diskutim	Vlerësimi i drejtë i aftësive të nx. dhe dhënia e ndihmës.	
Hartimi i Programeve për punën e mësimdhënësve me NZT	Tetor 2021	Timi; Mësimdhënës; Punëtorë profesionalë	Dokumente interne	Përjasje; Sistemim; Analizë	Hartimi i Programeve sipas aftësive individuale të nx.	
Udhëheqja e dosieve të nxënësve	Vazhdimisht gjatë tërë vitit shkollor	Timi; Mësimdhënës; Punëtorë profesionalë	Dokumente interne	Përjasje; Sistemim; Analizë	Përjasje më të mirë të përparimit të nx.	
Përcjellja e përparimit të nxënësve	Vazhdimisht gjatë tërë vitit shkollor	Timi; Mësimdhënës; Punëtorë profesionalë	Dokumente interne	Përjasje; Sistemim; Analizë	Përjasje më të mirë të përparimit të nx.	

### 8.13. Puna me nxënës me nevoja të veçanta

Për punën me nxënës me nevoja të veçanta (FNV), shkolla do të formojë timin inkluziv shkollor me këtë përbërje: Syrja Etemi-pedagog, Pranvera Iseri-defektologe, Burim Salihi-sociolog, Vjollca Xhaferi, mës. e c.klasor, Emri Ajdini, mës. i c.lëndor, Taxhedin Jonuzi-prind, Burim Baftjari-prind. Ky tim, përgjithësisht do të mundësojë :

- Funksionim më të suksesshëm të komunikimit dhe tolerancës dhe krijimin e mundësive të barabarta në mjediset sociale;
- Mbështetje fleksibile individuale të fëmijëve (FNV) nga ana e nxënësve dhe mësimeve;
- Pjesëmarrje të shtuar dhe aktive në procesin arsimor inkluziv (FMV) dhe kyçe praktike të prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore;
- Hartimi i planeve arsimore individuale konform aftësive, nevojave dhe përgatitja e secilit nxënës. **(Shih në aneks)**

### 8.14. Mbështetja tutoriale e nxënësve

Në shkollë do të sigurohet mbështetje tutoriale të nxënësve për ato lëndë që janë pjesë të planit mësimor gjatë rrjedhës së vitit mësimor, që do ta realizojë tutori – vullnetar duke u bazuar në respektimin e të gjitha kriterëve nëse ka nevojë për të njëjtët.

## 9. Aktivitetet jashtëmësimore

### 9.1. Klubet shkollore sportive

Gjatë vitit shkollor do të formohen disa ekipe, edhe ato në: Fudboll, Volejbol, Hedboll dhe basketboll.

Përzgjedhja do të bëhet sipas afinitetit dhe interes të nxënësve. Mësimdhënësi përgjegjës për këto ekipe sportive është ai i arsimit fizik-shëndetësor, përkatësisht, Zemri Idrizi.

Përmes trajnimeve nxënësit do të zbulojnë afinitetet dhe aftësitë e tyre sportive.

Konform Programit vjetor të punës, planifikohen edhe këto aktivitete jashtëmësimore përmes të cilëve nxënësit do të mund t'i zhvillojnë afinitetet e tyre, edhe atë:

Emri i aktivitetit	Qëllimi i aktivitetit	Muaji i realizimit
Kuizoteka shkollore (e nx.)	Sistematizimi dhe thellimi i njohurive nga shumë sfera	Tetor-maj
Foto konkurs	Sistematizimi dhe thellimi i njohurive nga fotografia	Mars-maj
Konkursi i artit figurativ	Sistematizimi dhe thellimi i njohurive nga arti figurative	Tetor-maj
Roleriada	Zhvillimi i shprehive dhe shkathtësive të shëndosha për sportim	Prill-maj
Apriliada	Argëtim – karakter rekreativ	Prill
Kampion i shahut	Zhvillimi i të menduarit logjikë	Tetor

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

### 9.2. Seksionet / klubet

Përmes aktiviteteve jashtëmësimore të nxënësve krijohen mundësitë për individualizim të procesit edukativo-arsimor, për përbushjen dhe zhvillimin e interesave dhe aftësive individuale të nxënësve për punë të përbashkëta, me ç'rast kontribuohet në besimin ndërshoqëror dhe shoqërimin në kohën e lirë.

Përmes punës dhe funksionimit të këtyre aktiviteteve, tek nxënësit nxitet dhe kultivohet kureshtja, pavarësia, kreativiteti dhe dëshira për përfitimin e njohurive të reja. Këto aktivitete u mundësojnë nxënësve të dallojnë përparësinë dhe prioritetin për shfrytëzimin e kohës së lirë.

#### Mësimi klasor

Emërtimi i seksionit	Mësimdhënësi	Numri i nxënësve
Seksioni i artit figurativ	Lirie Neimi	?
Seksioni ritmik, letrar	Zirafete Shasivari	?
Seksioni muzikor	Shqipe Idrizi	?
Seksioni i dramës	Vjollca Xhaferi	?

#### Mësimi lëndor

Emërtimi i seksionit	Mësimdhënësi	Numri i nxënësve
Seksioni letrar	Sihana Jashari	?
Seksioni i informatikanëve	Lejla Huseini	?
Seksioni i biologëve	Afërdita Baftjari	?
Seksioni sportiv	Zemri Idrizi	?
Seksioni i bibliotekës	Albulena Idrizi	?
Gjeografët e rinj	Zeqirja Jonuzi	?

### 9.3. Aksionet

Në shkollë organizohen panairë, hepeningje, ngjarje humanitare për shkak të Ditës së shkollë apo ndonjë rast jubilar tjetër, shënimi i festave sipas kalendarit me përmbajtje të definuara qartë, koha e realizimit dhe bartësit e aktivitetit të caktuar për realizimin dhe përcjelljen, në të cilën detyrimisht ka përfaqësues nga këshilli i prindërve. Për realizimin e të gjitha aktiviteteve të parapara përgatitet program i veçantë. **(Shih në aneks).**

### 10. Organizimi i nxënësve dhe pjesëmarrja

Pjesëmarrja e nxënësve ka një rëndësi të veçantë shoqërore dhe se është forma më e mirë përmes së cilës nxënësit mund të mësojnë si të veprojnë në raste të mbrojtjes së të drejtave të tyre dhe të tjerëve, madje, si të ndikojnë në lidhje me proceset e vendimmarrjes dhe si të participojnë në mënyrë demokratike në jetën e shkollës dhe të bashkësisë në përgjithësi.

Të gjithë nxënësit në shkollë e përbëjnë **bashkësinë e nxënësve**. Nxënësit kanë të drejtë në organizimin e tyre në nivel të paraleles dhe shkollës. Për realizimin më të organizuar të interesave të nxënësve në shkollë, nxënësit organizohen në bashkësi të paraleles dhe **parlamentit të nxënësve**. Parlamentin e nxënësve e përbëjnë kryetarët e bashkësive të paraleleve. Përmes këtij organizimi, nxënësit kanë mundësi të marrin pjesë në krijimin e klimës pozitive për punë dhe mësim në shkollë, ngritjen e raporteve dhe bashkëpunimeve shoqërore, si dhe mundësitë për zhvillimin e drejtë dhe funksionim komod të shkollës dhe bashkësisë së gjërë.

#### Parlamenti i nxënësve:

- në mënyrë aktive merr pjesë në përfaqësim dhe promovim të të drejtave dhe interesave të nxënësve;
- promovon aktivizimin e nxënësve;
- merr pjesë në aktivitete për mbështetje dhe siguri të bashkëmoshatarëve me nevoja të veçanta, në realizimin e mësimin dhe aktiviteteve jashtëmësimore;
- merr pjesë në përgatitjen e programit vjetor për punë;
- jep sugjerime për përfshirjen e aktiviteteve të ndryshme për programin vjetor të ekskursioneve;
- jep mendime e sugjerime për aktivitetet jashtëmësimore;
- merr pjesë në përmirësimin e standardit të nxënësve;
- merr pjesë në evaluimin dhe vetevaluimin e punës së shkollës;
- përmes përfaqësuesve të vet merr pjesë në këshillin e prindërve dhe të mësimdhënësve;
- organizon dhe merr pjesë në aktivitetet humanitare, ekologjike dhe punë të dobishme shoërore;

Programet për punë të bashkësisë së paraleles dhe për punën e parlamentit të nxënësve dhe avokatit të nxënësve, janë të paraqitur **në aneks**.

### 11. Aktivitetet jashtëshkollore

#### 11.1. Ekskursionet, pikniqet dhe mësimi në natyrë

Në kudër të pikniqeve , ekskursioneve dhe mësimin në natyrë, do të përfshijmë:

- Pikniku njëditor vjeshtor: Lokaliteti i quajtur: \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_
- Piknik njëditor pranveror: \_\_\_\_\_
- Mësim në natyrë për kl. V: **Strugë** (.....)
- Ekskursion mësimor-shkencor për kl.III \_\_\_\_\_ (Mavrovë)
- Ekskursion mësimor-shkencor për kl.VI \_\_\_\_\_ ( )
- Ekskursion mësimor-shkencor për kl.IX \_\_\_\_\_ ( )

### 11.2. Të dhëna për nxënësit e shkollës fillore të kyçur në aktivitetet jashtëmësimore

Aktivitetet jashtëmësimore do të realizohen përmes seksioneve shkollore, klubeve, ekskursioneve, garave dhe aktiviteteve tjera të cilat janë jashtë programeve mësimore si dhe aktivitetet e organizatave të nxënësve.

### 12. Garat e nxënësve

Gjatë vitit shkollor, nxënësit do të marrin pjesë në shumë gara komunale, regjionale dhe shtetërore. Pjesëmarrja në këto gara është sipas afiniteteve dhe aftësive të tyre.

### 13. Përparimi i multikulturalizmit/interkulturalizmit dhe integritit ndëretnik

Integrimi multikulturor paraqet prioritet në shkollë dhe, në këtë drejtim ndërmirren aktivitete përmes të cilëve nxënësi:

- nxitet në respektimin e dallimeve dhe karakteristikave ndryshe, pavarësisht nga përkatësia etnike, gjuhësore, gjinore, ngjyra dhe besimi;

- do të dijë të respektojë dhe nxitë zhvillimin e kulturës së vet dhe të përkrahë e mbështes vlerat e kulturave tjera;

- do të kontribuojë në luftimin e diskriminimit, të menduarit me paragjykime.

Përmes aktiviteteve hulumtuese nxënësit duhet t'i stirojnë mendimet e tyre, të mbështesin vlerat nga sfera e të drejtave të njeriut dhe për rregullimin demokratik të shoqërisë, të edukohen për një bashkëpunim dhe solidaritet me të tjerët.

Programin për realizimin e aktiviteteve për integrim në shkollën fillore e **paraqesim në aneks.**

### 14. Projektet që realizohen në shkollë

Në shkollë në mënyrë të vazhdueshme realizohen projekte në bashkëpunim me MASH-in, BZHA, USAID-in etj., bashkësinë lokale, firma, ndërmarrje etj. Momentalisht, shkolla jonë është e kyçur në projektin: **Arsimi në shekullin XXI dhe pretendon që edhe këtë vit mësimor të merr pjesë me trajnime dhe seminare për aftësimin e mësimitdhënësve për një qasje më të avansuar të procesit të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies.**

### 15. Mbështetja e nxënësve

#### 15.1. Të arriturat e nxënësve

Të arriturat e nxënësve janë pjesë përbërëse e raporteve për nxënësit, për suksesin dhe frekuentimin, të cilët rregullisht përcillen dhe shënohen dhe rregullisht shënohen apo evidentohen dhe bëhen krahasime të rezultateve dhe, mënyra dhe puna e njëjtë do të vazhdojë edhe këtë vit shkollor. Analizën e rezultateve të arritura do ta realizojë shërbimi profesional i shkollës.

Suksesi i arritur për vitin paraprak mësimor është **4.19.**

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

### Pasqyra e suksesit të nxënësve në fund të vitit shkollor 2020/21

Klasa	Nr. i nx.	Numri i nxënësve sipas suksesit të arritur				Numri i nxënësve me nota të dota				Suksesi mesatar
		5	4	3	2	Me 1x1	Me 2x1	Përsëritës	Të panot.	
I		<b>Nxënësit vlerësohen me notim përshkrues</b>								
II										
III										
IV										4.4
V										4.6
Gj.										4.5
VI										4.3
VII										3.9
VIII										4.1
IX										3.9
Gj.										4.0
Gj.										<b>4.19</b>

### Pasqyra e suksesit të nxënësve në fund të vitit shkollor 2019/20

Klasa	Nr. i nx.	Numri i nxënësve sipas suksesit të arritur				Numri i nxënësve me nota të dota				Suksesi mesatar
		5	4	3	2	Me 1x1	Me 2x1	Përsëritës	Të panot.	
I		<b>Nxënësit vlerësohen me notim përshkrues</b>								
II										
III										
IV										4.54
V										4.58
Gj.										4.56
VI										4.23
VII										3.85
VIII										3.65
IX										3.93
Gj.										4.12
Gj.										<b>4.10</b>

## Programi vjetor Sh.F.K. “Eqrem Çabej” Sllatinë - Tearcë

### Pasqyra e suksesit të nxënësve në fund të vitit shkollor 2018/19

Klasa	Nr. i nx.	Numri i nxënësve sipas suksesit të arritur				Numri i nxënësve me nota të dota				Suksesi mesatar
		5	4	3	2	Me 1x1	Me 2x1	Përsëritës	Të panot.	
I		<b>Nxënësit vlerësohen me notim përshkrues</b>								
II										
III										
IV										
V										
Gj.										
VI										
VII										
VIII										
IX										
Gj.										
Gj.										<b>4.12</b>

### 15.2. Orientimi profesional i nxënësve

Shkolla fillore komunale “Eqrem Çabej” – Sllatinë, kur është fjala për orientimin profesional të nxënësve, për çdo vit mësimor ndërton plan për realizimin e aktiviteteve të parapara, praktikë kjo që, edhe në këtë vit shkollor, nuk do të mungojë. Kështu, do të konsolidohet timi për orientim profesional të nxënësve (që do ta udhëheqë, **Burim Salih**), si dhe aktivitetet konkrete: njohje e nxënësve me profesione të ndryshme, përcjellja dhe detektimi i nxënësve me aftësi dhe interesa specifike, takimet me personalitete me profesione të ndryshme, realizimi i punëtorive, këshillimi profesional i nxënësve, promovimi i shkollave të mesme etj. Për këtë, shihni aneksin: **Plan për orientimin profesional të nxënësve.**

### 15.3. Promovimi i mirëqenies së nxënësve, mbrojtja nga dhuna, nga keqpërdorimi dhe abuzimi, parandalimi i diskriminimit

Shkolla fillore komunale “Eqrem Çabej” – Sllatinë, kur është fjala për Promovimin e mirëqenies së nxënësve, mbrojtja nga dhuna, nga keqpërdorimi dhe abuzimi, parandalimi i diskriminimit, për çdo vit mësimor ndërton plan për realizimin e aktiviteteve të parapara, kështu që, edhe në këtë vit shkollor, nuk do të mungojnë këto praktika. Kështu, do të konsolidohet timi për promovimin e mirëqenies së nxënësve, mbrojtja nga dhuna, nga keqpërdorimi dhe abuzimi, parandalimi i diskriminimit që do ta udhëheqë **Hamije Zilbehari**, si dhe aktivitetet konkrete (qëllimet, përgjegjësitë dhe procedurat), punëtoritë edukative me prindë, nxënës dhe

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

mësimdhënës, kyçjen e ekspertëve në sfera të caktuara, planifikimi i aktiviteteve në jetën e shkollës, si dhe jashtë saj, vizita të përbashkëta të institucioneve etj.

Krijohen dhe udhëhiqen Procedura për paraqitjen dhe mbrojtjen e nxënësit-viktimë të çfarëdo lloji të formës së ushtrimit të dhunës, keqpërdorimit apo abuzimit dhe diskriminimit. Për këtë, shihni aneksin: *Promovimi i mirëqenies së nxënësve, mbrojtja nga dhuna, nga keqpërdorimi dhe abuzimi, parandalimi i diskriminimit.*

### 16. Notimi

#### 16.1. Llojet e notimit

Klasa	Tremujori i parë	Gjysmëvjetori	Tremujori i tretë	Fundviti
I-III	Notim me shkrim	Notim me shkrim	Notim me shkrim	Dëftesë; Notim me shkrim
IV	Notim me shkrim	Notim numerik	Notim me shkrim	Dëftesë; Notim numerik
V	Notim me shkrim	Notim numerik	Notim me shkrim	Dëftesë; Notim numerik
VI	Notim me shkrim	Notim numerik	Notim me shkrim	Dëftesë; Notim numerik
VII-IX	Notim numerik	Notim numerik	Notim numerik	Dëftesë; Notim numerik

Lëndë për përcjellje, verifikim dhe vlerësim të veprimtarisë edukativo- arsimore do të jenë rezultatet e arritura në përvetësimin e përmbajtjeve edukativo-arsimore, shprehitë punuese, shkallë të interesimit dhe angazhimit në mësim dhe aftësi praktik për aplikim të diturive. Arritje të nxënësve që të vlerësohet me aplikim të strategjive të ndryshme të vlerësimit. Notimi duhet të jetë shprehje e orvatjeve të nxënësve gjatë orës mësimore si dhe jashta orëve. Për këtë qëllim, mënyrat e notimit duhet të jenë të llojllojshme edhe atë:

- Vlerësimi gojarisht (që bazohet mbi standardet e vlerësimit dhe Taksonomisë së Bllumit)
- Vlerësimi me shkrim (përmes testeve objektive)
- Vlerësimi formativ (gjatë vetë orës mësimore)
- Vlerësimi sumativ (në gjysmëvjetor dhe në fund të vitit).

**Vlerësimi gojarisht:** Përcaktimi i notës numerike që duhet të përfshijë arritjet e nxënësit krahas të mbajturit mend dhe reproduktimit të përmbajtjeve mësimore, kuptimit dhe përvetësimit të përmbajtjeve mësimore, përkatësisht aftësive të nxënësit për interpretim të me fjalë të veta, zbatimi i përmbajtjeve mësimore në detyrat konkrete me elemente të njohura dhe elemente të panjohura, si dhe aftësi më të larta intelektuale për analizë, sinteza dhe vlerësimi, që nënkupton aftësinë e nxënësit për rregullim, kombinim të elementeve në tërësi të reja dhe aftësi të nxënësit për vlerësim të arsyeshem të ndonjë konstatimi ose vepre.

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

**Nota numerike** përcaktohet në këtë mënyrë:

- Nota mjaftueshëm dy (2) – dituritë e nxënësve kanë të bëjnë me të mbajturit mend dhe reproduktimin; nxënësi duhet të njohë dituritë e ofruara, të definojë, të reprodutojë fakte, të numërojë, të emërojë nocione dhe të zbatojë dituri në detyra më të thjeshta.

- Nota mirë tre (3) – dituritë e nxënësve kanë të bëjnë me të kuptuarit dhe përvetësuarit e diturive, shkathtësive dhe shprehive; nxënësi është i aftë të interpretojë fakte e të njohë terme e nocione të nivelit mesatar.

- Nota shumë mirë katër (4) – dituritë e nxënësve kanë të bëjnë me detyra të elementeve të njohura dhe të reja; nxënësi mund të analizojë fakte dhe praktikisht t'i zbatojë dituritë, logjikisht të mendojë dhe të ketë mendimin e tij, vazhdimisht të jetë aktiv, të jetë i përgjegjshëm, i rregullt në mësim dhe obligime, të interpretojë, të krahasojë dhe t'i analizojë dhe ilustrojë me shembuj kritik duke u bazuar në dituritë e përvetësuar.

- Nota shkëlqyeshëm pesë (5) – dituritë e nxënësit kanë të bëjnë me analizë, sintezë dhe vlerësim; nxënësi mund të zbatojë dituritë në zgjidhjen e detyrave me elemente të njohura; është i aftë për mendim logjik dhe zbatim praktik të fakteve; ka qëndrime të ndërtuara; është i aftë të sistematizojë dhe gjeneralizojë, të hulumtojë dhe zbatojë dituritë; është i aftë për lidhjen e teorisë me praktikën; shfrytëzon burime plotësuese; parashtron dhe përgjigjet në pyetje në lidhje me tema të ndryshme.

**Vlerësimi me shkrim:** Pas çdo tërësie tematike, verifikohet niveli i diturive përmes testeve objektive (pyetje nga 4 nivelet sipas Taksonomië së Bllumit, pyetje me rrethim, plotësim, me bashkim, me sqarime, me zgjidhje etj.). Për këtë qëllim, fitimi i pikave është në mënyrën vijuese: prej 30% deri më 50% suksesi i realizmit të testit pason nota dy (2), prej 50% deri më 70% pason nota tre (3), prej 70% deri 85% nota katër (4) dhe prej 85% deri 100% nota pesë (5).

**Vlerësimi formativ:** është një proces që realizohet në vetë orët mësimore, përmes të cilave nxënësit dhe arsimtarët shqyrtojnë shkallën e përvetësimit të materies, problemeve me të cilat ballafaqohen, çfarë duhet të ndryshohet dhe ku duhet të fokusohen më tepër për përvetësim më të suksesshëm të materialit mësimor.

**Vlerësimi sumativ:** Pason si rezultat i të gjitha formave të lartpërmendura të notimit dhe realizohet në fund të gjysmëvjetorit dhe në fund të vitit shkollor.

### 16.2. Timi për përcjellje, analizë dhe mbështetje

Timin për përcjellje, analiza dhe mbështetje do ta përbëjnë:

- Shërbimi profesional
- Dy mësimdhënës lëndor
- Dy mësimdhënës klasor

Timi do të punojë sipas programit që do ta hartojë në muajin shtator, dhe që do të përfshijë aktivitete të orientuara në mbështetjen e nxënësve në arritjen e rezultateve më të mira, mbështetje të mësimdhënësve të cilët, gjithashtu arrijnë rezultate më të larta në punën e tyre dhe të atyre që ballafaqohen me vështirësi eventuale. **(Shih në aneks)**

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

### 16.3. Vizita profesionale për përcjelljen dhe vlerësimin e kualitetit të punës së kuadrit edukativo-arsimor

Gjatë vitit shkollor, drejtori dhe bashkëpunëtorët profesionalë përmes instrumenteve të përgatitur dhe korniza e verifikuar kohore-paraprakisht, do të bëjnë vizita në orë mësimore që do të realizojë kuadri arsimor-edukativ i shkollës, edhe atë dy herë gjatë vitit shkollor, përkatësisht një herë të çdo mësimdhënës-për një semestër.

### 16.4. Vetevaluimi i shkollës

*Shkolla fillore komunale: "Eqrem Çabej" - Sllatinë, në mënyrë të vazhdueshme ka pretenduar dhe po kujdeset në ngritjen e cilësisë së mëimit dhe mësimdhënies, përmirësimin e kualitetit të arsimit dhe edukimit me të arriturat e nxënësve në shkollë. Një segment të rëndësishëm në këtë drejtim paraqet edhe diagnostifikimi i gjendjes konkrete, i cili bëhet përmes procesit të vetevaluimit të punës së shkollës fillore në përgjithësi, në të cilin aktivitetet përfshihen një numër i caktuar subjektësh, si nga ana e mësimdhënësve, nxënësve, madje, prindërve, po ashtu edhe nga ana e autoriteteve të MASH dhe BZHA - së. Meqë një aktivitet të këtillë e realizuam vitin shkollor paraprak, dhe se vetevaluimi bëhet në çdo dy vjet, sivjet nuk parashihet ta bëjmë këtë aktivitet, por të njëjtin do ta realizojmë vitin e ardhshëm shkollor ku do ta bëjmë duke u bazuar në këtë skemë (siç e kemi praktikuar vitet pararendës):*

#### **Pasqyrë e timeve për evluimin e punës së shkollës**

<b>Nr. ren.</b>	<b>SFERAT</b>	<b>KOORDINATORËT E TIMEVE SIPAS SFERAVE</b>
<i>I</i>	Planet dhe programet mësimore	
<i>II</i>	Arritjet e nxënësve	
<i>III</i>	Mësimi dhe mësimdhënia	
<i>IV</i>	Përkrahja e nxënësve	
<i>V</i>	Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë	
<i>VI</i>	Resurset	
<i>VII</i>	Udhëheqja, menaxhimi dhe krijimi i politikave të shkollës	

*Të punësuarit tjerë nga kuadri arsimor në shkollë, caktohen në mënyrë proporcionale në secilën sferë të Vetevaluimit.*

### 17. Sigurimi në shkollë

*Në shkollë, për sigurimin e mësimdhënësve, nxënësve dhe të gjithë të punësuarve, ndërtohet plan për mbrojtje dhe shpëtim nga katastrofat natyrore si dhe plan për preventivë nga kushtet pandemike. Konform këtij plani, të punësuarit dhe nxënësit marrin pjesë në ushtrime simuluese. **(Për këtë, në aneks, paraqesim planin për mbrojtje dhe shpëtim).***

### **18. Kujdesi për shëndetin**

#### **18.1. Higjiena në shkollë**

*Për mbajtjen në nivel të higjienës në shkollë, në mënyrë të vazhdueshme përdoren mjete higjienike-sanitare e dezinfektuese të nivelit apo të kualitetit të lartë e cilësor. Në raport me mbajtjen e higjienës në shkollë, rregullisht bëhet pastrimi i të gjitha hapësirave në shkollë, edhe atë një herë në javë bëhet pastrim gjeneral i hapësirave të shkollës. Përveç kësaj, dy herë gjatë vitit (janar, korrik) bëhet dezinfektimi dhe deratizimi nga Qendra për shëndet publik. Mësimdhënësit, në bashkëpunim me prindët do të mbajnë llogari për zhvillimin e shprehive tek nxënësit për mbajtjen e higjienës personale.*

#### **18.2. Kontrollimet sistematike**

*Kontrollimet sistematike për nxënësit planifikohen të realizohen para ose pas mbarimit të orëve të rregullta mësimore, pa mos u penguar mësimi. Gjatë vitit shkollor kontrollimet sistematike bëhen për nxënësit nga kl. I-VII në shoqërim të udhëheqësve të paraleleve. Nx. e kl. I dhe III detyrimisht i shoqërojnë prindërit e tyre. Kontrollimet sistematike kryhen në Ambullantën Shëndetësore - Tearcë dhe Spitalin e Tetovës.*

*Nga ana e shkollës bëhet edhe kontrollimi oral (gjendjes shëndetësore të gojës dhe dhëmbëve), bëhet për nxënësit nga kl. I-VI. Gjithashtu planifikohen punëtori edukative për dhëmbë të shëndoshë (për nxënësit e kl. I-VI). Këto lloje të kontrollimeve bëhen në Klinikat adekuate në Tetovë.*

#### **18.3. Vaksinimi**

*Imunizimi (vaksinimi) bëhet për nxënësit e mësimit klasor dhe atë lëndor sipas orarit për vaksinim nga Enti për shëndet publik. Nxënësit shoqërohen nga ana e kujdestarëve të klasave (udhëheqësit e paraleleve). Në këtë aktivitet përfshihen të gjithë nxënësit e shkollës sonë duke filluar që nga klasa I e deri në atë të IX.*

#### **18.4. Edukimi për ushqim të shëndoshë**

*Shkolla kujdeset për Edukimin e nxënësve për ushqim të shëndetshëm njëkohësisht edhe për ngritjen e vetëdijes për të ushqyerit e shëndetshëm dhe përfitimi prej tij. Janë të kyçura ligjerata edukative nga ana e prindërve dhe ekspertëve të fushave adekuate, që realizohen në aktivitetet jashtëmësimore. Përveç kësaj, mësimdhënësit në orë të bashkësisë së klasës përpunojnë tema nga ushqimi (të ushqyerit) e shëndetshëm. Gjithashtu, në orët e rregullta mësimore përpunohen përmbajtje të ndërlidhura në mënyrë direkte apo indirekte me mënyrën e të ushqyerit të shëndetshëm, prodhimin e ushqimit organik etj. Qëllimi për përparimin e shëndetit të nxënësve është formimi i personalitetit të shëndoshë të nxënësit (individit), i cili do të jetë i aftë për t'u kujdesur për shëndetin personal por edhe të tjerëve në rrethin ku jeton (sipas definimit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë).*

### 19. Klima shkollore dhe raportet në shkollë

#### 19.1. Disiplina

*Në lidhje me sjelljen dhe disiplinën, në shkollë janë evidente probleme të ndryshme të cilat, si gjithnjë po pretendojmë t'i zgjidhim. Si më prezente janë disa veprime aberante të disa nxënësve, si: pirja e duhanit, vonesa për në mësim, apo ikja nga orët mësimore, madje zënkat dhe rrahjet ndërmjet nxënësve, mosrespektimi i rendit shtëpiak të shkollës etj.*

*Shkolla në mënyrë të vazhdueshme po punon dhe do të punojë edhe këtë vit mësimor në amortizimin e këtyre manifestimeve devijante dhe problemeve të paraqitura, qoftë nga ana e mësimit në kuadër të orëve të klasës, të këshillit të arsimtarëve, qoftë nga ana e shërbimit pedagogjik apo nga ana e drejtorisë së shkollës. Për rastet më drastike, Këshilli i arsimtarëve shqipton edhe masa pedagogjike, kurse në bashkëpunim me Këshillin e prindërve, Këshillit të B.L dhe Këshillit të shkollës -pronarëve të kafiterive përreth shkollës, të cilët shesin edhe gjëra që mund të dëmtojnë shëndetin e fëmijëve, do t'u parashtrohet vërejtje me shkrim;*

*Nga përcjellja e procesit të gjithëmbarsuem edukativo-arsimor nga ana e shërbimit pedagogjik, madje edhe nga ana e Komisionit për vlerësim, veçmas në segmentin e raporteve ndërkolegiale, madje, në relacionin: mësimit nënxënës; bile, nga bisedimet e anketimet me mësues, nxënës, prindë e subjektë tjerë, kemi të dhëna të cilat determinojnë një konstatim apodiktiv si vijon: Raportet apo marrëdhëniet në relacionin: mësimit nënxënës - nxënës dhe anasjelltas janë në një farë mase interkomunikative - me tendenca imponimi të një edukimi autoritativ nga ana e disa arsimtarëve, "sediment" këto që rishtazi ua zënë frymën raporteve demokratike në shkollë;*

*Kur bëhet fjalë për raportet ndërgjinore të nxënësve, shpesh shprehen tendenca të "dominimit fizik" të disa nxënësve të gjinisë mashkullore ndaj atyre femërore, karakteristikë e cila gjenezën e ka në marrëdhëniet patriarkale të mjedisit ku gjendet shkolla. Këto veprime, nuk mund t'u atribuohen edhe raporteve të provinencës ndëretnike (në shkollën periferike);*

*Të prirur nga indikacionet e patriarkalizmit, mentalitetit ekstensiv të mbarsur me primesa paragjykmore të disa familjeve nga të cilat vijnë edhe nxënësit e kësaj shkolle, ndodh shpesh që nxënësit me pengesa në zhvillimin fizik, por edhe intelektual, të bëhen objekt talljeje dhe përçmimi në shkollë, por edhe në shoqëri. Për këtë arsye, është më se e domosdoshme puna profesionale me këta nxënës, por edhe me familjet nga të cilat rrjedhin ata. Prandaj, ndihma e institucioneve adekuate dhe shoqatave të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare është e mirëseardhur;*

*Shkolla gjithnjë pretendon të jetë e hapur për personat e interesuar për informim rreth punës dhe rrjedhës së procesit edukativo-arsimor, përkundër inercionit të shprehur nga ana e disa individëve (mësimit nënxënësve).*

*Bashkëpunimi me këta faktorë apo subjektë të jashtëm që i përmendëm shtrihet përmes kontakteve individuale apo grupe të parapara edhe me Programin e punës së shkollës.*



## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

---

Në këtë kapitull përfshihen të gjitha përcaktimet programore shkollore (interne) të cilat kontribuojnë për zhvillimin edukativ dhe përsosje profesionale të bashkëpunëtorëve profesionalë dhe mësimdhënësve. Përkrah tyre, në mënyrë edukative do të marrim pjesë në të gjitha seminarët dhe punëtoritë educative të organizuara nga ana e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, USAID-it apo ndonjë Organizatë tjetër joqeveritare dhe provajderë tjerë të akredituar nga ana e MASH-it.

### **21. Bashkëpunimi i shkollës fillore me prindët / tutorët**

#### **21.1. Kyçja e prindërve/tutorëve në jetën e shkollës**

Ky bashkëpunim nënkupton inkadrimin e shkollës fillore në rrethin ku është lacuar për informimin me rezultatet e arritura, situatat dhe problemet që e preokupojnë si dhe shumë bashkëpunime tjera, duke filluar nga prindërit si subjekt më të interesuar për punën e shkollës.

Bashkëpunimi i shkollës sonë edhe këtë vit shkollor do të realizohet përmes aktiviteteve të llojllojshme shoqërore, kulturore dhe arsimore edhe atë përmes mbledhjeve, takimeve, shfaqjeve e manifestimeve të ndryshme.

#### **21.2. Kyçja e prindërve/tutorëve në procesin mësimor dhe aktiviteteve jashtëmësimore**

Prindët gjithnjë do të jenë të kyçur në procesin e nxënies dhe do të jenë të informuar me planin dhe programin mësimor, si dhe vet procesin mësimor në mënyra të ndryshme, edhe atë:

- përmes Këshillit të prindërve
- përmes takimeve individuale dhe grupore me mësimdhënësit
- përmes shërbimit profesional të shkollës
- përmes E-ditarit
- përmes Webfaqes zyrtare të shkollës

Prindët marrin pjesë aktive në organizimin dhe realizimin e hepeningjeve dhe ekskursioneve ( të kyçur në komisione), aktivitete jashtëmësimore, ligjerata nga prindët, në projekte, organizimin e garave dhe vizitat e institucioneve.

Prindët kyçen në sjelljen e qëndrimeve në nivel të paraleleve dhe përmes Këshillit të prindërve. Ata japin ide dhe propozime për realizim të aktiviteteve të caktuara në shkollë. Në Këshillin e shkollës tre nga anëtarët janë nga prindërit. Ata gjithashtu japin kontribut të theksuar në punën e Këshillit të shkollës.

#### **21.3. Edukimi i prindërve/tutorëve**

Edukimi i prindërve bëhet përmes punëtorive edukative për prindët. Udhëheqësit e paraleleve në takime me prindë sipas nevojës organizojnë ligjerata dhe punëtori edukative. Shërbimi profesional sipas programit të tyre për punë, organizojnë punë konsultative-këshillëdhënëse dhe ligjerata të tipizuara me shkrim në këto tema: Adaptimi i nxënësve të kl. parë, problemet zhvillimore

*te nxënësit. Rreziqet e përdorimit të smart-telefonave, Orientimi profesional Formimi i shprehive pozitive të fëmijët, Të drejtat dhe liritë e fëmijëve, Respektimi i dallimeve , Stop diskriminimit, dhe tema tjera kështu të ngjajshme – përmes informimeve, flauerëve etj.*

*Shkolla harton broshurë në të cilën paraqiten të gjitha informacionet e nevojshme për planet e shkollës në vitin shkollor në vijim, rregulloret për sjelljen e nxënësve dhe prindërve , rekomandimet për adaptimin e nxënësve të klasës së parë në shkollë, projektet, kontaktet, bashkëpunimet dhe informacionet tjera për edukimin e prindërve me tema të ndryshme. Broshura shtypet (botohet) gjatë muajit gusht me qëllim të promovimit të punës së shkollës, dhe gjatë rrjedhës së vitit shkollor.*

### **22.Komunikimi me publikun dhe promovimi i shkollës**

#### **22.1 Bashkësia vendore (vetqeverisja lokale, komuniteti i biznesit, bashkësia vendore...)**

*Punën edukative-arsimore në këtë sferë programore e planifikojmë me qëllim që të vëhen në funksion pedagogjik të gjithë resurset që mund t'i ofrojë bashkësia vendore për realizimin më të suksesshëm të detyrave programore të shkollës. Përmes bashkëpunimit, shkolla jonë ndikon në ngritjen e nivelit kulturo-arsimor të banorëve lokal. Përmes kësaj sfere i realizojmë këto detyra:*

- Shfrytëzimi i mundësive profesionale, kulturore dhe materiale të mjedisit lokal për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë edukativo-arsimore të shkollës.*
- Këmbimi i dijes, mendimit dhe përvojave me kuadrin mësimor dhe shërbimit profesional nga shkollat tjera të komunës dhe bashkësisë vendore.*
- Aktivitete që do të kontribuojnë në promovimin e vlerave qytetare dhe ndërlidhjen shkollës me bashkësinë vendore.*

#### **22.2. Institucionet nga sfera e kulturës**

*Për ngritjen e kulturës së jetës dhe zhvillimit të dashurisë ndaj artit (filmit, baletit, operës, dramës, pikturës etj.) realizohen vizita të institucioneve të cultures ( galeri, teatër). Gjithashtu, detyrimisht planifikohen dhe se përcillen konkurset dhe garat në të cilat nxënësit marrin pjesë aktivisht nën mentorimin e mësimdhënësve.*

#### **22.3. Institucionet nga sfera e arsimit**

*Shkolla ka bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të frytshëm me këto institucione nga sfera e arsimit: MASH, BZHA, ISHA, Aktivin e drejtorëve në nivel të komunës, shkollat fillore komunale dhe të mesme. Me institucionet e përmendura, shkolla vendos forma më të nduarnduarta të bashkëpunimit: këshillëdhënëse dhe ndihmë profesionale, përsosje profesionale të kuadrin mësimor, koordinimi i punës , këmbimi i përvojave, gara ndërshkollore, orientimi profesional i nxënësve (shih: Planin në Shtojcë), mentorimi i studentëve të fakultetit pedagogjik, shfrytëzimi i literaturës profesionale etj.*

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

### 22.4. Organizatat shëndetësore

Meqë kujdesi për shëndetin e nxënësve është një nga detyrat më të rëndësishme në procesin edukativo-arsimor, shkolla në këtë plan do të bashkëpunojë me numër të konsiderueshëm të institucioneve shëndetësore, në mes tyre janë: Spitali shëndetësor – Tetovë, reparti mjekësi shkollëore, Ambullanta Shëndetësore - Tearcë, Qendra për kujdes social, Qendra për shëndet publik etj. Shkolla bashkëpunon me qendrën për kujdes social për tejkalimin e problemeve të nxënësve të cilët vijnë nga familjet disfunkcionale.

### 22.5. Mediumet (me qëllim të promovimit të shkollës)

Me qëllim të promovimit të aktiviteteve në shkollë, edhe këtë vit shkollor do të vazhdohet me bashkëpunimin me Programin edukativ shkollor të TVMV, si dhe mediumet e shtypura.

### 23. Përcjellja e implementimit të programit vjetor për punën e shkollës fillore

Duke i njohur raportet dhe situatat në shkollë dhe duke shfrytëzuar rezultatet nga përcjellja në periudhat e mëparshme, por edhe duke patur parasysh edhe angazhimet e anëtarëve të Këshillit në punët dhe detyrat dhe kualitetin e angazhimit në përcjellje, në vitin shkollor 2021 / 2022, plani do të ndërtojë vetëm disa procese prioritare, të cilët, rëndom kanë të bëjnë me përmirësimin e mësimin, të nxënësve dhe të arriturave të nxënësve.

Sferat prioritare për përcjellje	Mënyra dhe koha e përcjelljes	Përgjegjës	Kush duhet të jetë i informuar për përcjelljen
Zgjerimi i shkollës me kabinete	Gjatë vitit shkollor	Drejtori	Drejtori e ndihmës drejtoresha dhe personat përgjegjës
Pajisja e sallës së fizikulturës me rekuizita dhe pajisje adekuate	Gjatë vitit shkollor	Drejtori	Drejtori e ndihmës drejtoresha dhe personat përgjegjës të timeve
Përparimi i kompetencave të mësimdhënësve për një mësimdhënie dhe mësim më efikas në distancë	Gjatë vitit shkollor	Drejtori	Drejtori e ndihmës drejtoresha dhe personat përgjegjës të timeve

### 24. Evaluimi i programit vjetor për punën e shkollës fillore

Gjatë vitit shkollor, në periudha të caktuara do të bëhet evaluimi i të gjitha aktiviteteve të planifikuara të parapara në Programin vjetor të shkollës, e të planifikuara përmes programeve të hartuara. Krejt këtë aktivitet do t'i realizojnë timet apo ekipet e caktuara nga ana e drejtorit të shkollës përmes: pyetësorëve, dokumenteve, procesverbaleve, raporteve dhe instrumenteve tjerë. Krejt aktivitetet do të evidentohen dhe dokumentohen në raportin e shkollës në Gjysmëvjetor dhe në periudhën e Fundvitit.

### 25. Përfundim

*Ne si shkollë, gjithnjë synojmë të nxisim zhvillimin individual të nxënësve, promovojmë mirëkuptimin dhe respektimin e ndërsjellë, zhvillojmë përgjegjësinë dhe nevojën për prurje të reja. Shkolla jonë përherë ka mbështetur dhe po mbështet zhvillimin profesional të mësimeve, me ç'rast shton efikasitetin e procesit edukativo-arsimor. Gjithnjë po orientohemi dhe synojmë që nxënësve t'u mundësojmë dije cilësore dhe afatgjata, që kontribuojnë në formimin dhe zhvillimin e arsimit të mëtejshëm.*

*Ndihmojmë dhe nxisim bashkëpunimin e përbashkët ndërmjet nxënësve, prindërve dhe mësimeve, me ç'rast ndihmohet në zhvillimin e besimit dhe respektimit të ndërsjellë. Për të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me procesin edukativo-arsimor të nxënësve, gjithnjë në kohë dhe paanshmëri informohen edhe prindët përmes Këshillit të Prindërve, në mënyrë individuale dhe grupore në takime të planifikuara nga ana e mësimeve dhe shërbimit profesional dhe webfaqen zyrtare të shkollës.*

*Shkolla jonë është e kyçur në një numër të konsiderueshëm të projekteve, për çka mbështetje të padiskutueshme marrin nga ana e prindërve, nxënësve, mësimeve, komunës, ndërsa dobishmëria është qëllimi për përmirësimin, përkatësisht aplikimin e noviteteve në procesin edukativo-arsimor.*

### 26. Komisioni për hartimin e Programit vjetor për shkollën fillore:

- Lulzim Idrizi - drejtor
- Hamije Zilbehari - nd. dr.
- Syrja Etemi - pedagog
- Burim Salihi - sociolog
- Emri Ajdini - mës.i c.l.
- Igballe Behadini - mës.i c.klasor
- Imer Imeri- mës.i c.lëndor
- Vjollca Xhaferi- mës.i c.klasor

### 27. Literatura e shfrytëzuar

Programi i Sh.F.K. "Eqrem Çabej" –Sllatinë është i hartuar në bazë të këtyre dokumenteve:

- Ligji për arsim fillor
- Ligji për mësime dhe punëtorë profesionalë
- Rregullorja për punën e mësimeve dhe punëtorëve profesionalë
- Statuti i shkollës
- Aktet nënligjore
- Planet dhe programet për arsim nëntëvjeçar
- Programi dhe raporti i punës së shkollës nga viti shkollor paraprak
- Raporti nga evaluimi integral nga viti paraprak
- Vetevaluimi i shkollës
- Plani zhvillimor
- Raporti financiar për punën e shkollës

## **ANEKSE**

## Programi vjetor Sh.F.K. “Eqrem Çabej” Sllatinë - Tearcë

---

### **ORGANI UDHËHEQËS (DREJTORI I SHKOLLËS)**

Në përputhje me Ligjin për arsim fillor dhe të gjithë ligjet dhe rregulloret tjera që lidhen me punën e shkollave fillore dhe sipas detyrave të parapara me Plan - programin arsimor, është paraparë edhe Programi për punën e drejtorit për vitin shkollor 2021/22. Programi përcakton realizimin e detyrave në këto fusha: Planifikimi dhe programimi i punës arsimore, Organizimi i punës në shkollë, Punë këshilluese - konsultative me arsimtarët dhe shërbimet profesionale, Punë analitike – hulumtuese, Kontrollim dhe analizë e evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit, Përsosja profesionale e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë.

Realizimi i programit për punë të drejtorit bazohet në këto fusha Menaxhimi financiar; Përfaqësimi i shkollës; Pjesmarrje në përgatitjen e raporteve: Kordinimi i punës së organeve të shkollës. Përcjellja dhe analiza e procesit arsimor. Pjesmarrja dhe përcjellja e qëllimëve parësore të shkollës. Analizë dhe planifikim. Punë dhe bashkëpunimin me bashkësinë vendore

Drejtori i institucionit angazhimet e veta do t'i drejtoj drejt vendosjes në realizimin e detyrave programore dhe njëkohësisht do të jetë promotori dhe koordinatori kryesor i gjithë veprimtarisë arsimore në shkollën fillore. Drejtori të gjithë veprimet do t'i kryejë në kuadër të ligjeve ekzistuese si dhe detyrat dhe kopetencat që dalin nga statusi dhe aktet ligjore e nënligjore.

Qëllimi parësorë për të cilin drejtori do të angazhohet është menxhimi efikas dhe profesional i punës së insticionit në çdo aspekt.

Qëllimi kryesor i drejtorit të shkollës sa i përket stafit është krijimi i klimës pozitive në punë , përmirësimi i kushtëve për qëndrimin e fëmijëve në shkollë, stimbulimi I të punësurve që të shprehin kreativitetin e tyre , motivi dhe nxitja për të spikatur idetë e tyre dhe duke ndërthurur idetë dhe të dilet me një ide të përbashkët që të jetë e pranueshme për të gjithë.

Puna ekipore në kolektiv është çelësi i suksesit të një institucioni. Segmenti bazë për realizimin e suksesshëm të veprimtarisë, para së gjithash është ndertimi i partneritetit dhe marrëdhënieve mes familjeve të fëmijëve dhe vetë qeverisjes lokale.

Ministria e arsimit, Byroja për zhvillim të arsimit, shkollët fillore në nivel shteti, instiucionet parashkollore, partneriteti me instiucionet profesionale që janë segmentet kryesore për realizimin e suksesshëm të veprimtarisë edukivo - arsimore.

Planifikimi është faza kyçe në procesin e menaxhimit sepse nga cilësia e planit varet zhvillimi i përgjithshëm i organizatës dhe besueshmëria në punë. Planifikimi kursen kohë dhe mundëson shfrytëzimin sa më optimal të burimeve të çdo lloji, si dhe minimizon konfliktet në organizatat . Shkurt, mund të themi se planifikimi i menaxhimit është i dobishëm i rëndësishëm dhe prfitabil.

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

---

Organizatrat që punojnë në një mjedisë në shkallë të gjerë kanë nevojën më të madhe për një planifikim cilësor dhe të gjithanshëm. Ata kanë nevojë për një proces planifikimi që të jenë në gjendje të rimendojnë vazhdimisht dhe të vlerësojnë aktivitetet e tyre dhe të detyrojnë të gjenden mënyra të reja dhe më të mira për të bërë punën e tyre. Planifikimi shpesh përcaktohet si një vizion racional për të ardhmen. Sa më ilartë të jetë niveli i menaxhimit, aq më i gjatë duhet të jetë vizioni. Sidoqoftë, ai duhet të jetë i kuptueshëm për menaxherët e nivelit më të ulët, sepse përpjekjet e përgjithshme nuk do të jenë të frytshme nëse të përfshirët në punë nuk e dinë saktësisht se çka pritet prej tyre.

Planifikimi është funksionimi më i rëndësishëm në menaxhim. Ai përfshin përzgjedhjen e qëllimëve dhe aktiviteteve për realizimin e tyre, që na dërgon në një shkallë të caktuar të së ardhmes të cilën duam të arrijm dhe, nënkupton shpirtin inovativ të menaxherit.

Drejtori i shkollës në pajtueshmëri me ligjet rregulloret dhe statusin e shkollës kryen funksionin menaxherial që kërkon një qasje të plotë, serioze dhe të përgjithëshme për punën.

Drejtori e udhëheq shkollën drej transformimit dhe aplikimin e inovacioneve me qëllim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe punës në përgjithësi në shkollë. Programi i punës të drejtorit është pjesë integrale e programit vjetor të shkollës dhe ai do të përkushtohet në realizimin cilësor të saj .

Programi i punës së drejtorit përfshin këto aktivitete:

Udhëheqje dhe menaxhim, planifikim dhe programim, koordinim, udhëzime dhe kontroll, raporte, analizë dhe vlerësim, inform dhe prezentim, udhëheqje me stafin kontroll, inkurajim, vlerësim, ruajtje e rendit dhe disciplines, ndihmë në tejkalimin e problemeve dhe zgjidhja e problemeve.

Përsosja vetanake (personale):

Të mësuarit dhe përsosja personale, kryeaktiviteti në punë, menaxhimi me kriza; përpunimi i informacioneve, vlerësimi, analizë dhe vlerësim, hulumtim, verifikim dhe raportim, komunikim, bashkëpunim me bashkësinë vendore.

Komunikimi në kolektiv:

Korrespondencat administrative, informim për të arriturat në punë me prezentim.

Puna e drejtorit do të realizohet në kuadër të të gjitha fushave programore, edhe atë :

1. Planifikim dhe programim.
2. Organizim.
3. Udhëheqje.
4. Evaluim dhe hulumtim.
5. Punë pedagogjike-instruktive.
6. Punë dhe detyra tjera.

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

### Planifikimi dhe programimi

Përmbatja	Koha e realizimit	Shënime
<p>Përfundimi i Raportit Vjetor për vitin shkollorë 2020/2021.                      Analizë e arritjeve nga viti shkollor i mëparshëm.                      Përgatitja e Programit Vjetor për punën edukativo - arsimore për vitin shkollorë 2021/2022, përcaktimin I prioriteteve, qëllimeve, aktiviteteve për këtë vit shkollor.                      Përgatitja e orarit të shkolles dhe orarit për arsimtarët kudjestar.</p>	Gusht	<p>Në bashkëpunim me të gjitha strukturat në shkollë. Pjesë integrale e programit janë fushat e punës së shkollës që përgatiten nga mësuesit dhe bashkëpunëtorët profesionalë pas informacionit të marrë nga puna e përgjithshme e shkollës, Oraret e oreve dhe kudjestarit në bashkëpunim me arsimtarët e përcaktuar.</p>
<p>Perpilimi I programit për punë të Këshillit arsimor dhe programit për punë të Këshillit të klasave.</p>	Gusht	<p>Në bashkëpunim me pedagogun dhe procesverbalistë të Këshillit të Mësuesve.</p>
<p>Përgatitja e programit të punës së drejtorit të shkollës.</p>	Gusht	<p>Drejtori</p>
<p>Planifikimi i zhvillimit profesional të stafit mësimdhënës</p>	Shtator	<p>Ekipi i arsimtarëve përgadit program për përsosje profesionale , në bashkëpunim me pedagogun, gjithashtu çdo arsimtar ka plan personal për përsosje profesionale për vitin shkollor 2021/22</p>
<p>Shpërndarja e oreve, formimi i paraleleve për klasën e parë dhe angazhimet e tjera të stafit mësimdhënës</p>	Korrik-Gusht	<p>Në bashkëpunim me pedagogun dhe komisionin për regjistrim të fëmijëve në klase të parë.</p>
<p>Plan për rregullimin e shkollës dhe oborrit të shkollës.                      -Plani i financiar dhe plani i prokurimit publik                      - Lista e përparësive për blerjen e ndihmave vizuale, literaturës profesionale dhe materialeve të tjera në vitin shkollor.                      - Lista e përparësive për blerjen e mjeteve të nevojshme teknike higjienike dhe materialeve të tjera.</p>	Gusht-Shtator	<p>Në bashkëpunim me Komunen dhe të punësuarit në shkollë Këshilli I shkollës Këshilli I prindereve ,Këshilli I shkollës : Komisioni për prokurim public,sekreti, arsimtarët shërbimet profesionale aktivet profesionale dhe personeli teknik.</p>

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

### Organizimi

Organizimi i aktiviteteve me rastin e Ditës së Parë të shkollës, Shënimi I patriotit të shkollës Shënimi i Javës së Fëmijëve Organizimi I manifestimit për Vitin e Ri . Organizimi I manifestimeve për datat e rëndësishme nga historia e Kombit tone.(Festat 22 dhe 28 Nëntor, 7 Mars). Dhe aktivitete tjera shoqërore humanitare argetuese etj.	Gjate gjithë vitit shkollorë.	Në bashkëpunim me Ekipin për jetën argëtuese kulturore.
Organizimi i punës së aktiveve profesionale	Gusht, Shtator, Dhjetor.	Nëse është e nevojshme, drejtori do të ndërhyjë në organizim.
Përcaktimi i orarit të punës: orari i orëve mesimore , mesim shtues dhe plotësues aktivitete jashtë mesimore dhe aktiviteteve tjera.	Shtator	Në bashkëpunim me arsimtarin përgjegjës për hartimin e orarit. dhe bashkëpunëtorët profesional, komisionet dhe ekipet në shkollë.
Organizimi i punës materiale, financiare dhe administrative- teknike të shkollës.	Gjatë gjithë vitit	Në bashkëpunim me administratën dhe kontabilistin e shkollës.
Organizimi I procesit të evaluimit dhe përcjellja e qëllimeve të parashtruara nga planifikimi zhvëllimor për këto vite	Periodikisht	Në bashkëpunim me pedagogun, koordinatoret për vetëevaluim, ekipin për planin zhvëllimor.

### Udhëheqja

Sjellja e vendimeve dhe zgjedhjeve kadrovike .	Shtator	Nëse është e nevojshme gjatë gjithë vitit
Sjellja e vendimeve në lidhje me infrastrukturën .	Gjatë gjithë vitit	Drejtori
Marrja e vendimeve për të përmirësuar rendin e brendshëm dhe disiplinën e shkollës.	Gjatë gjithë vitit	Ekipi i klimës shkollorë, Ekipi i disiplinës
Marrja e vendimeve në lidhje me funksionimin dhe punën përditshëm në shkollë	Gjatë gjithë vitit	Me stafin dhe të gjithë autoritetet në shkollë
Planifikimi, implementimi dhe menaxhimi i këshillit të klasës dhe mësuesve.	Gjatë gjithë vitit	Drejtori, pedagogu,

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

### Hulumtim dhe evaluim

Rishikimi dhe analizimi i planeve vjetore globale dhe tematike për punën e mësuesve, mesimit shtesë, poltesues, multikulturalizëm, TIK, aktivitete të kohës së lirë, përmbajtje eko	Shtator, Planet Tematike do të rishikohen gjatë gjithë vitit.	Në bashkëpunim me pedagogun, mësuesit
Shqyrtimi dhe analizimi i planeve vjetore të punës së bashkëpunëtorëve profesiona	Shtator	Drejtori
Shqyrtimi dhe analizimi i përgatitjeve ditore të mësuesve sipas planit për vlerësimin e përgatitjeve	Gjatë gjithë vitit	Në bashkëpunim me pedagogun
Percellja e mesimit të detyrueshëm zgjedhor ,shtues plotesues, dhe aktiviteteve të lira.	Gjate gjithe vitit	Në bashkëpunim me pedagogun dhe kryetaret e aktiveve profesionale
Percjellja e punës së stafit administrativ dhe teknik	Për çdo ditë	Në bashkëpunim me të punesuarit.
Percjellja e rregullsisë dhe kudjestarise të punsuarve	Për çdo ditë	Drejtori dhe shërbimi profesional
Percjellja e punës aktiveve profesionale. Zhvillimi i fleksibilitetit pedagogjik midis aktiveve profesionale për aplikimin e metodave aktive të punës në mësimdhënie.	Gjatë vitit shkollor	Drejtori dhe shërbimi profesional
Percjellja e realizimit të programit vjetor (të gjitha fushat dhe përmbajtjet programore)	Për çdo ditë	Në bashkëpunim me pedagogun
Percjellja e aplikimit të modeleve dhe teknikave të ndryshme të të nxënës në mësimdhënie	Gjatë vitit shkollor	Ekipi për persosjen profesionale të mësuesve
Percjellja për aplikim të kompjuterit dhe teknologjive tjetëra bashkëkohore në mesim	Gjatë vitit shkollor	Në bashkëpunim me pedagogun
Percjellja e vlerësimit ( Notimit).	Sipas programeve të punës të akt. Prof.	Metodat, teknikat, testet dhe llojet e tjera të vlerësimit
Percjellja e evidences pedagogjike dhe dokumentacionit sipas programeve të punës të aktiveve profesionale.	Njeher ne muaj	Në bashkëpunim me pedagogun
Monitorimi i Planit për përsosje Profesionale- zhvillimi profesional i stafit mësimdhënë.	Gjatë vitit shkollor	Ekipi i zhvillimit profesional të mësuesve
Percjellja e punës të kudjestareve të klasave.	Gjatë vitit shkollor	Analiza e suksesit dhe sjelljes, realizimi i planeve mes.
Analiza e suksesit dhe sjelljes, realizimi i planeve mesimore	Në fund të çdo tre mujori	Përmes raporteve dhe analizave dhe raportit vjetor

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

### Puna pedagogjike-mësimore

Puna individuale pedagogjike-mësimore me mësuesit dhe mësuesit e rinj	Gjatë vitit shkollor	Ndihmë konkrete profesionale për tejkalimin e problemeve dhe dobësive të përdtëshme.
Bashkëpunim me nxënësit dhe organizatat e tyre	Gjatë vitit shkollor	Drejtori dhe shërbimi profesional
Bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale, prindërit, MASH, BDE, organizatat joqeveritare, media.	Gjatë vitit shkollor	Drejtori dhe shërbimi profesional.
Pasqyrë e planifikimit vjetor dhe tematik për punën e mësuesve	Gjatë vitit shkollor	Pedagogu
Kontrollimi i librave amëdhe ditarëve të klasave.	Gjatë vitit shkollor	Pedagogu dhe komisioni për kontrollimin e ditareve dhe librave kryesor.
Vizitë dhe evidentimi i oreve të vizituara.	Gjatë vitit shkollor	Pedagog, defektologu dhe aktivet profesionale
Njohja e të punësuarve me akte juridike, rregullore, kod, sistematizim dhe akte të tjera ligjore.	Gjatë vitit shkollor	Në bashkëpunim me sekretarin e shkollës

### Punë dhe detyra tjera

Pjesëmarrja në punën e Këshillit të Shkollës.	vazhdimisht	Drejtor
Bashkëpunim me Këshillin e Prindërve	vazhdimisht	Drejtor
Bashkëpunim me MASH, BDE, mjedisin lokal		Bashkëpunim me median, komunitetin lokal dhe institucionet e tjera, etj.
Bashkëpunim me shkollat e tjera	Sipas interesit të të dy palëve	Drejtor
Kujdesi për funksionimin juridik të shkollës në prokurimin publik, organizimin e ekskursioneve.	Përgatitja e projektit	Drejtor
Aktivitetet projektuese për prezantimin dhe afirmimin e shkollës.	vazhdimisht	Drejtori dhe shërbimi profesional
Puna me nxënës.	Individualisht dhe në orët e klasë	Në bashkëpunim me mësuesit.

Drejtori do të kryejë veprimtari të tjera që janë në domenin e tij, në përputhje me rrjedhën normale të procesit arsimor dhe të gjitha nevojat e nxënësve dhe jetën e përgjithshme në shkollë.

Drejtori, Lulzim Idrizi

# Programi vjetor Sh.F.K. “Eqrem Çabej” Sllatinë - Tearcë

---

## PROGRAMI VJETOR I PUNËS SË NDIHMËS DREJTORIT TË SHKOLLËS

### Plani global vjetor për punën e nd.drejtorit në shkollë

#### Hyrje

Plani global vjetor për punën e nd. drejtorit edhe këtë vit bazohet në qellimet e parashtuara, detyrat, drejtimet dhe udhëzimet në dokumenta.

Dispozita nga Ligji për arsimin fillor si dhe ligjet tjera dhe rregulloret të cilat i përkasin arsimit fillor si dhe të drejtat dhe obligimet e të punësuarve në këtë sferë.

Plani mësimor dhe planprogramet mësimore për arsim fillor.

#### Orari I punës së nd.drejtorit (javor)

Ne kuadër të orarit të punës 40 orësh të nd.drejtorit të shkollës sonë , angazhimin e vet do ta fokusojë ne aktivitetet vijore.

1. Punë instruktive –pedagogjike
2. Këshilli me prindërit
3. Bashkpunim me bashkësit shoqërore
4. Bashkpunimi me shërbimet profesionale organet e shkollës
5. Bashkpunimi me organet udhëheqëse të shkollës
6. Bashkpunim me organizatat e nxënësve dhe Këshillin e prindërve
7. Punë juridiko-administrative
8. Punë analitiko- hulumtuese
9. Punë në evidencën dhe dokumunikacionin pedagogjike

#### Detyrat e punës globale të nd.drejtorit

Duke u nisur nga qëllimet dhe detyrat e përcaktuara nga dokumentat e lartpërmendura dhe duke pasur parasysh kushtet dhe nevojat e shkollës , nd.drejtori i shkollës gjatë vitit shkollorë aktivitetin e vet do t'a përqendroj ne ceshtjet dhe nevojat per punën normale kandidatëve të shkollës dhe përmbajtjen e qëllimeve dhe detyrave që burojnë nga ato.

- Përgaditja tekniko-administrative për fillim të sukseshëm të vitit shkollor në shkollë.
- Përcaktimi I orëve për lëndet mësimore dhe arsimtarëve .
- Përcaktimi I problemëve në klasë .
- Aktivitetet për formimin e paraleleve ne klasë të parë.
- Aktivitete për përpilimin e planprogramit të shkollës .
- Plotësimi me kohë I vendeve të lira të punës.

## Programi vjetor Sh.F.K. “Eqrem Çabej” Sllatinë - Tearcë

---

- Aktivitet për kycjen dhe krijimin e kushtëve për punë të projekteve ekzistuese dhe të reja në shkollë.
- Pjesëmarrjen në përpilimin dhe përcaktimin e orëve të kudjestarisë.
- Aktivitete për pjesmarrje të organizuar për arsimtarët në seminare për përpilimin e programeve të reja mësimore.
- Organizimi I aktiviteteve për rregullimin e evidencës dhe dokumentacionit petagogjikë për vitin e ri mësimor.
- Organizimi I aktiviteteve për provojen në vjete të reja mësimore.
- Organizimi I aktiviteteve për planet globale dhe tematike të arsimtarëve.
- Planifikimi I aktiviteteve për punë analitiko- hulumtuese.
- Organizimi I aktiviteteve për punë ekipore në shkollë
- Aktivitete për rregullimin dhe sanimin e objektit e shkollës
- Aktivitete për punën e Parlamentit të nxënësve.
- Aktivitet për punën e Këshillit të prindërve.
- Aktivitet dhe bashkëpunim me shkollat tjera, organet dhe organizatat të cilat kanë të bëjnë me punën e suksesshme të shkollës
- Percjellja e procesit edukativo-arsimor dhe përsëritja dhe përparim profesional i arsimtarëve.
- Aktivitete rreth bashkpunimit të shkollës dhe nxënësve me mjetet o informimit publikë dhe resurseve për fëmijë.
- Vizitë në ore dhe analizë e tyre.
- Kontrollimi I përgaditjeve ditore të arsimtarëve dhe dhenia e këshillave për përmisimin e tyre kualitativ.
- Nga aktivitetet dhe ongazhimet e larteshnuara të nd.drejtorit gjatë vitit shkollorë 2021\22 do të jenë të orientuara në të gjitha sferat punës së fushveprimit, që do të thotë se programi është i hapur për plotësime të tjera të panifikuara.

### **Plani global vjetor per punën e ndihmësdrejtorit të shkollës**

#### **Qëllimet strategjike:**

- ❖ Perparimi I kualitetit të mësimit dhe arsimtarëve të shkollës fillore komunale “Eqrem Cabej” Sllatinë –Tearcë.
- ❖ Implimentimi I motivit pershkrues I mësimit klasor.
- ❖ Ndërtimi I sistemit për vlersim dhe notim të arsimtarëve.
- ❖ Persosja profesionale e arsimtarëve.
- ❖ Implementimi I risive në sistemin arsimorë nëntëvjecar.

#### **Detyrat prioritare**

- ❖ Implementimi I ndryshimeve dhe plotësimeve në planet mësimore në arsimin fillor.
- ❖ Implementimi I notimit përshkrues në mësimin klasor klasa e I-II-III.
- ❖ Permiresimi I procesit mësimor duke zbatuar shkathëtesi (teknika) të mësuarit.
- ❖ Zbatimi I planit strategjik për përparimin e shkollës.

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

### Programi i punës vjetore përfshinë këto fusha:

- Admidnistrative-organizative
- Dokumentet programore
- Pedagogjike-instruktive
- Punë analitike- hulumtuese

### Administratë – punë organizative

Përmbatja e aktiviteteve	Qëllimi I aktiviteteve	Mënyra e realizimit	Koha e realizimit	Bashkëpunëtori (Në bashkëpunim)
- Pjesmarje në përgaditjen e planit për angazhimin me punë të kudrit arsimor sipas lendëve, orëve dhe kudjestaret e klaseve.	Përgaditje e duhura për fillimin e vitit shkollor.	- Takime me aktivet profesionale. - Pene ekipore	Gusht Shtator	Drejtori Pedagogu Kryetaret e aktiveve profesionale.
- Përpilimi i orarit të orëve për vitin mësimor.	Përgaditja ne kohë për fillimin e vitit shkollor.	- Bisedë dhe konsultime me arsimtarët. - Punë teknike.	Gusht Shtator	Drejtori
- Kontrollimi i përgaditjeve vjetor, tematike dhe ditore.	Mbikqyrje dhe perkrahe profesionale për përpilimin e planëve.	- Kontroll. - Bisedë dhe konsultime me arsimtarët. - Punë teknike.	Gushte Shtator	Drejtori Pedagogu Kryetaret e aktiveve profesionale.
- Organizimi dhe realizimi i mësimin shtesë dhe plotësues dhe aktiviteteve tjera.	Perfshirja dhe roli i ketij mësimi për përforcimin e kualitetit në mësim.	- Kontroll. - Bisedë dhe konsultime.	Shtator Qershor	Drejtori Pedagogu Kryetaret e aktiveve profesionale.
Kontrollimi I ditareve për punën e arsimtarëve	Azhurimi I evidencës petagogjike dhe dokumentacionit.	- Kontroll - Raport - Pune teknike	Shtator Tetor	Drejtori Ekipi për evaluim
Përgaditjet për mbajtjen e Këshillit arsimor dhe Këshillit të prindërve.	Pjesmarrje aktive e të gjithë subjekteve në organizimin dhe realizimin e punës edukativo-arsimor.	- Bisedë konsulltim - Punë ekipore	Shtator Qershor	Drejtori Ekipi për evaluim
Regjistrimi I nxënësve në klasë të parë.	Ndarja e nxënësve në paralele.	- Bisedë dhe konsultime me kudjestarët e klaseve.	Gusht Shtator	Drejtori Pedagogu

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

Pjesmarrje në shënimin e patriotit të shkolles si dhe ndihma për organizimin dhe realizimin e garave shkollore	Përgaditja e nxenesve për pjesmarrje në shënimin e patriotit dhe pjesmarrje në garat shkollore, komunale, rregjionale dhe republikane.	- Orari - Lajmerimet dhe - raporti	Tetor Shkurt Maj	Drejtori Pedagogu Kryetaret e aktiveve profesionale.
Takime me aktivet profesionale	Mbykqyrje për realizimin e palnifikimeve të aktive profesionale dhe programeve mësimore	Raport dhe mbykqyrje	Shtator Qershor	Drejtori Pedagogu Kryetaret e aktiveve profesionale.

### Dokumente programore

Permatja dhe aktivitetve	Qëllimet e aktiviteve	Mënyra e realizimit	Koha e realizimit	Bashkëpunëtori (Në bashkëpunim)
Përgaditja e programeve vjetore për punën e shkolles.	Përmbajtja e rregullativës ligjore.	Raport për kualitetin e realizimit të programës vjetore të vitit paraprak dhe shfrytëzimi i literatures profesionale.	Gusht Shtator	Drejtori. Ekipi për përgatitjen e programit.
Përgaditja e programit për punë individuale të ndihmësdrejtorit .	Përgaditja në kohë për punën dhe detyrat vitit në vijim.	Raport për realizimin e aktiviteve dhe shfrytëzimi i literatures profesion.	Gusht Shtator	Drejtori. Pedagogu

### Punë instruktive - pedagogjike

Përmbajtja e aktivitetit.	Qëllimi i aktivitetit	Mënyra e realizimit	Koha e realiz.	Bashkëpunëtori
Punë instruktive me arsimtarët fillestar.	Dhënja e udhëzimeve për përgaditjen kualitative të palneve globale, tema ditore dhe pjesmarrje në oraganizimin e përmbajtjeve mësimore.	Konsultime, individuale: Shfrytëzimi i literatures profesionale.	Shtator	Drejtori Pedagogu
Përcjellja e punës gjatë notimit përshkruar.	- Relalizimi i sukseshem i notimit përshkruar.	Mbikqyrje Seminare interne	Shtator Qershor	Drejtori Ekipi për evaluim
Përcjellja e mësimit plotësues dhe shtues nëpërmjet lëndëve të vecanta mësimore.	- Mbikqyrje ndaj angazhimit të arsimtarëve dhe motivimit të nxënësve.	Mbykqyrje Raport	Shtator Qershor	Drejtori Ekipi për evaluim

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

Vizitë në orë mësimore (klasa e parë)	- Aktivitet të nxënësve në procesin edukivo-arsimor.	Mbykqyrje Raport	Shtator Qershor	Drejtori Pedagogu
Vizitë në orë mësimore Mesimi lëndor Gjuhë shqipe	- Pjesmarje në realizimin e programëve të reja nga gjuha shqipe.	Mbykqyrje Raport	Shtator Qershor	Drejtori Pedagogu
Vizitë në orë mësimore (klasa VI-të)	- Pjesmarja në realizimin e përgaditjeve të reja programore.	Mbykqyrje Raport	Shtator Qershor	Drejtori Pedagogu

### Punë analitiko-hulumtuese

<b>Përmbaja e aktiviteteve</b>	<b>Qëllimi i aktiviteteve</b>	<b>Mënyra e realizimit</b>	<b>Koha e realizimit</b>	<b>Bashkëpunëtori (Në bashkëpunim)</b>
Analizë e punës dhe implemetimit.	Analizë kualitative dhe kuantitative dhe njohja me të arriturat e projekteve të realizuar.	Mbykqyrje Analizë	Maj Qershorë	Drejtori Ekipi për evaluim
Përgaditje për analizën e raporteve të suksesit sjellës së nxënësve në gjysmëvj. e parë dhe në fund të vitit arsimor.	Analizë e suksesit të nxënësve dhe vertetimin e qëllimëve prioritarë për vitin e ardhëshëm.	Punë ekipore Raport Analizë	Janar Qershor	Drejtori Ekipi për evaluim
Analizë për implemetimin e notimit përshkrues.	Përcaktimi i nivelit të kualiteti të detyrave të parashtrura dhe identifikimi i vështirësive dhe i problemeve në realizimin e programës.	Punë ekipore Raport Analizë	Qershor	Drejtori Ekipi për evaluim
Raport për nivelin dhe realizimin kualitativ të programit vjetor.	Pasqyrimi i rezultateve të arritura dhe përcaktimi i prioritetëve për vitin e ardhëshëm.	Punë ekipore Raport	Qershor	Drejtori Ekipi për evaluim
Raport nga mbyqyrja pedagogjike	Përcjellja e përparimit dhe përmisimi i kuadrit arsimor.	Punë ekipore Raport	Qershor	Drejtori Pedagogu

## PROGRAMI PËR PUNËN E PEDAGOGUT TË SHKOLLËS

### 1. Hyrje

Gjatë strukturimit të programit për punën e pedagogut në këtë vit shkollor kemi parasysh këto njohuri dhe nevoja të shkollës:

- Vëzhgimi i notave të cilat janë dhënë në raportin për punën e shkollës gjatë vitit të kaluar.
- Problemet dhe detyrat e vështira pedagogjike që janë të inkorporuara në programin vjetor të shkollës për këtë vit m.
- Vazhdimësi në realizimin e programeve paraprake të pedagogut të shkollës.
- Risi thelbësore të cilat janë përmbajtur si kërkesë e re e koncipimit të dokumentit – bazat e planifikimit të përmbajtjeve dhe organizimit të procesit edukativo – arsimor të shkollës filllore.
- Bazë e programimit të punës së pedagogut në arsimimin fillor.
- Angazhime vetjake në bazë të misionit të qëllimeve strategjike dhe modernizimit të arsimit në kontekst të programit nacional për zhvillimin e arsimit në RMV.
- Ndryshimet inovative në planet dhe programet mësimore në nivel të klasave.
- Planifikimet zhvillimore të shkollës.
- Realizim të suksesshëm të projekteve:
- Ligji për arsimin fillor.
- Statuti i shkollës.

### 2. DETYRA PRIORITARE

1. Koordinimi i kuadrit arsimor dhe ekipi profesional në shkollë me përfaqësuesit e MASH dhe BZHA për realizim më të suksesshëm të procesit arsimor me sjelljen e Strategjive të reja të mësimin fillor nëntëvjeçar.
2. Ndjekja e programeve të reja të Kembrixhit.
3. Ndjekja e zbatimit të mësimin inovues - përshtatur sipas nevojave dhe mundësive të nxënësve.
4. Ndjekja e notimit në funksion të vlerësimit real dhe objektiv të diturive të nxënësve dhe rritja e motivimit të tyre, testimi, notimi objektiv.
5. Informimi dhe bashkëpunimi në aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore.
6. Përkrahja e proekteve që implementohen në shkollë.
7. Koordinim i punës me aktivet profesionale.
8. Implementimi i projektit për integrim ndëretnik në shkollë në të gjithë fushat të punës si pedagog.

### 2.1 Vëzhgimi i punës edukativo-arsimore

#### *Detyra të ndryshme punuese të kësaj fushe:*

- Ndjekja e formave, metodave, planifikimi i mësimit të rregullt, shtues, plotësues dhe zgjedhorë.
- Ndjekja dhe respektimi i ligjshmërisë në arsimin fillor.
- Ndjekja e aktiviteteve jashtëmësimore dhe të lira të nxënësve.
- Ndjekja e programit vjetor për punën e shkollës
- Ndjekja e planifikimit të kuadrit mësimit.
- Ndjekja e vazhdueshmërisë dhe objektivitetit gjatë vlerësimit të nxënësve në mësimin e rregullt dhe aktivitetet jashtëmësimore.
- Ndjekja e evidencës pedagogjike, dokumentacioneve ped. dhe E- ditarit.
- Ndjekja e aftësisë profesionale të arsimtarëve.
- Ndjekja e funksionimit të organeve dhe këshillave të shkollës.
- Ndjekja, vlerësimi dhe gradimi i punës personale.
- Ndjekja e programeve të reja të Kembrixhit

#### *Në këtë fushë do të realizohet ndjekja e këtyre detyrave konkrete:*

Ndjekja e organizimit dhe realizimit të mësimit në përgjithësi, si edhe realizimin e lëndëve të reja zgjedhore që ofrohen në nivel të klasave.

Ndjekja e zbatimit të mësimit kualitativ të përshatatur sipas nevojave dhe mundësive të nxënësve dhe vlersimit të tyre objektiv.

Ndjekja e notimit në funksion të vlerësimit real dhe objektiv të diturive të nxënësve dhe rritja e motivimit të tyre.

Ndjekja dhe organizimi i punëtorive praktike të aktiveve profesionale në të gjitha nivelet (mësimi lëndor dhe klasor), në bazë të vëzhgimit dhe projektimit të të njëjtës nga ana e nxënësve dhe arsimtarëve në bashkëpunim me dr.e shkollës. Ndjekja e planifikimit të arsimtarëve dhe bashkëpunimi dhe edukimi reciprok nga problematika e mësimit procesual dhe integrimi i aktiviteteve mësimore dhe projektuese në përmbajtjet mësimore. Ndjekja e realizimit të aktiviteteve projektuese nga të cilit, me akcent të veçantë - të udhëheqjes dhe menaxhimit të paraleles, mësimi i integruar dhe tejkalimi i situatave dhe konflikteve; ndjekja e nxënësve të talentuar dhe fëmijë me vështirësi në mësim.

### 2.2 Punë këshillëdhënëse – konsultative

#### *Detyra punuese të ndryshme të kësaj fushe*

Punë konsultative-këshillëdhënëse me kuadrin mësimit, kujdestarët e klasave dhe bibliotekisten e shkollës.

Punë konsultative-këshillëdhënëse me drejtorin dhe anëtarët e tjerë të ekipit menaxhues dhe bashkëpunëtorët profesionalë.

Punë konsultative-këshillëdhënëse me përgjegjësit e ekipeve profesionale dhe përgjegjësit e aktiveve dhe seksioneve.

Punë këshillëdhënëse me anëtarë të organeve dhe këshillave të shkollës.

Punë këshillëdhënëse me arsimtarët – praktikanë.

Punë këshillëdhënëse me prindërit.

Punë këshillëdhënëse me nxënësit( të talentuar, me vështirësi në mësim, dhe me ngecje mentale).

Punë këshillëdhënëse në kontekst të aftësisë dhe përparimit të procesit edukativo-arsimor.

*Në këtë fushë do të realizohen këto detyra konkrete*

Punë këshillëdhënëse me arsimtarët të cilët realizojnë mësim në klasat e nënta.

Punë këshillëdhënëse me mësimin klasor nga klasa e parë deri në të tretë sipas programit të Kembrixhit.

Punë këshillëdhënëse me udhëheqësit e bashkësive të klasave dhe udhëheqjes në nivel të bashkësisë shkollore prej kl. VI – IX, në lidhje me suksesin, vëzhgimin dhe projektimin e mësimin. Respektimin e të drejtave të tyre, participimi i tyre në sferat e jetës shkollor edhe përshtatja e interakcioneve demokratike me arsimtarët dhe drejtorinë e shkollës, respektimin në mes të gjitha subjektëve në mjedisin shkollor.

Punë këshillëdhënëse – instruktive me përgjegjësit e aktiveve profesionale nga mësimi lëndor dhe klasor në lidhje me aktivitetet e SIT-it. (Implementimi i të gjitha risive nga aktivitetet projektuese të theksuara te fusha e ndjekjes së mësimin, vlerësimi formativ me të gjithë komponentët, ndjekja e zhvillimit të portfoliove të arsimtarëve dhe nxënësve).

Punë këshillëdhënëse me kuadrin arsimor dhe me prindërit e fëmijëve të cilët tregojnë sukses të dobët, pa rregullshmëri dhe prishjes së disiplinës,

Bashkëpunim me mjedisin lokal dhe punë instruktive me faktorët e jashtëm (NJVL. Mediat) në kontekst të promovimit dhe marketingut të shkollës.

### 2.3 Punë analitike – kërkimore

*Detyra punuese të ndryshme të kësaj fushe*

- Shkalla e përvetësimit të leximit me të kuptuar të nx. kl. gjashtë dhe përgatitja e raportit.
- Vlerësimi i përvetësimit të teknikës së leximit alogjik (kl.II).
- Përshtatje sociale dhe emocionale në klasën e parë.
- Vlerësimi i përvetësimit të teknikës së shkrimit të shkronjave në klasën e tretë (diktim).
- Teknikat e leximit në klasën e katërt.
- Anketë në klasën e VII-të për mungesat e paarsyeshme.
- Anketë për vlerësimin objektiv në klasën e VIII dhe IX-të.
- Anketë për orientim profesional.
- Përgatitja e analizave dhe raporteve.

*Në këtë fushë do të realizohen këto detyra konkrete:*

- Metodologjia e programit të Kembrixhit sjellë në përmirësimin dhe suksesin e shkathtësive të nxënësve.

### 2.4 Aftësim profesional i kuadrit edukativo-arsimor

#### *Detyra punuese të ndryshme të kësaj fushe:*

Aftësimi profesional i kuadrit mësues për funksionimin e ekipeve shkollë për përkrahje të projekteve të cilët realizohen në shkollë.

Aftësim profesional nëpërmjet temave profesionale, seminareve, punëtorive:

Raport dhe analizë nga testimi i kryer.

Aftësim profesional nëpërmjet raporteve dhe analizave nga ndjekja e mësimit dhe aktiviteteve jashtëmësimore.

Aftësim profesional nëpërmjet literaturës profesionale-nëpërmjet përdorimit të teknikave dhe metodave mësimore bashkëkohore.

Aftësim profesional individual nëpërmjet ndjekjes së seminareve, këshillave dhe leximit të literaturës profesionale.

Aftësimi profesional i arsimtarëve fillestar.

Përsosja në lidhje me testimet dhe rangimi sipas rezultateve të njëjta.

*Në këtë fushë do të realizohen këto detyra konkrete*

Aftësimi profesional në lidhje me aktivitetet e SIT – timit dhe aktiviteteve tjera në projektin.

Aftësim profesional i kuadrit arsimor nëpërmjet seminareve të brendshme, punëtorive për mënyra të reja, teknika për implementim të suksesshëm të qëllimeve nga projektet (vlerësimi formativ i portfoliove të arsimtarëve dhe nxënësve).

Aftësim profesional dhe trajnimi i përgjegjësve të aktiveve profesionale dhe kuadrit arsimor i cili ka ndjekur trajnimet si dhe zbatimin e risive në mësim (programe inovuese), vëzhgimi dhe projektimi i mësimit, inovimi i planifikimeve vjetore (procesuirimi dhe integrimi i përmbajtjeve).

Trajnimi i arsimtarëve për përgatitjen e testeve

Aftësim profesional i kujdestarëve të klasave në lidhje me futjen e menaxhimit në klasë dhe participimi demokratik i nxënësve në shkollë.

Biseda konsultative profesionale me arsimtarët dhe nxënësit – talent dhe nxënësit me vështirësi në përparim, mësim aktiv dhe përshtatje emocionale dhe sociale të nxënësve me tema të ndryshme.

Aftësim i mënyrave të komunikimit transparent në shkollë dhe mjedisit lokal si dhe bashkëpunim midis shërbimit profesional, arsimtarëve dhe prindërve, NJVL, mediumet lokale.

### 2.5. Evidenca pedagogjike dhe dokumentacioni

Për punën e vetjake të evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit do të përgatiten:

- planifikimi i ditarit me punë pedagogjike instruktive në shkollë;
- programi vjetor për punën e pedagogut;
- program operativ vjetor;
- ditarë kronologjik për punën;

## Programi vjetor Sh.F.K. "Eqrem Çabej" Sllatinë - Tearcë

- ditarë për punë këshillëdhënëse me nxënësit, arsimtarët, prindërit;
- ditarë për ndjekjen e orëve mësimore;
- evidencë për pjesëmarrjen e nxënësve në gara dhe rezultatet e arritura;
- ditarë për evidencën e nxënësve të rinj dhe të nxënësve të çregjistruar;
- sjellja e dosies profesionale të arsimtarëve;
- përgatitja e materialeve profesionale, instrumenteve, tabelave etj;
- evidenca, raportet prezantime prej të gjitha qëllimeve prioritare dhe aktiviteteve që do të jenë lëndë për t'u ndjekur.

Në punën time do t'i përdor: Ligjin për arsim fillor, Statutin e shkollës, Rregulloren nga fusha e arsimit fillor, Programin vjetor për punën e shkollës, Orarin për mësimin e rregullt, plotësues, shtues, zgjedhor, Aktiviteteve të lira të nxënësve dhe fletoret evidentuese për realizimin e projekteve.

### PROGRAMI OPERATIV PËR PUNËN E PEDAGOGUT GUSHT

N. r.	Përmbajtja	Qëllimet - detyrat	Veprimet format, metodat	Bashkëpunëtorë	Efektet e pritura
1	Regjistrim plotësues të fëmijëve në klasën e parë.	Grumbullimi i fëmijëve dhe pyetja për njohuritë paraprake	Tekst, dialog	Prindërit, nxënësit, nd.drejtoresha	Përfshirja e përgjithshme dhe rritja e numrit të nxënësve
2	Shpërndarja e nxënësve në klasave të parë.	Krijimi i paraleleve	Tekst, dialog, bisedë	Arsimtarët	Shpërndarja sipas kriterit klasë homogjene
